

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7062
E martë, 5 dhjetor 2023
Çmimi 0.50 €

Hasani: Rezoluta 1244 dhe Arbitrazhi, ndër pikat e kuqe në draft-statutin për Asociacionin FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-së SI "ORGANIZATË TERRORISTE"? (11)

GJENEZA E TERMIT 'DREJTORI POLITIKE' E UÇK-së



Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë "Epokës së re", në vazhdimin e pjesës së njëmbëdhjetë, ka folur për gjenezën e termit "drejtori politike" e

UÇK-së. Në këtë intervistë ai tregon se nga kush lindi kjo ide dhe kush e përkrahi. Bardhyl Mahmuti, po ashtu, tregon se nga kush e mori besimin që ta përfaqësonte UÇK-në vetë i dyti në një takim me diplomatët amerikanë.

"Kërkesë e vetme e ShBA-së ishte që takimi në fjalë të mos bëhej publik nga ana jonë përpara se ta bënin publik amerikanët në momentin kur ta gjykonin të arsyeshëm", ka thënë Bardhyl Mahmuti


RIVARROSET TRUPI I LIRIDONA ADEMAJT, FAMILJA HAP TË PAME NË FSHATIN RRACAJ F. 6



SEJDIU: OPOZITA PA KUALITET, ABDIXHIKU KRYETAR I LDK-së ME QASJE TË PARREGULLT F. 7



AKTUALE



IZRAELI URDHËRON EVAKUIM MASIV NË JUG TË GAZËS, POR PALESTINEZËT S'KANË KU TË IKIN MË F. 2

PROKURORIA NË HAGË: DO T'I NDJEKIM TË GJITHË ATA QË FRIKËSOJNË DËSHMITARË F. 3

HAZIRI: NJË LLOJ KONFEDERATE PO KËRCËNON TË KRIJOHET NË KOSOVË F. 7

EKONOMI



RRETH 80 MIJË EURO OBLIGIME NDAJ MINATORËVE, SINDIKATA I JEP NJË JAVË KOHË MENAXHMENTIT TË "TREPÇËS" F. 8

BIZNESET SHOIPTARE NË ZVICËR HAPIN DYERT PËR QYTETARËT E KOSOVËS F. 8

SPORT



ISMAJLI: SHOIPËRIA DHE KROACIA KALOJNË GRUPIN F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Izraeli urdhëron evakuim masiv në jug të Gazës, por palestinezët s'kanë ku të ikin më

JERUSALEM, 4 DHJETOR - Ushtria e Izraelit i ka ripërtërirë thirrjet të hënën për evakuim masiv nga qyteti jugor i Rripit të Gazës, Kan Jounis, ku kanë kërkuar strehim dhjetëra mijëra palestinezë të zhvendosur në javët e fundit. Zgjerimi i ofensivës tokësore dhe bombardimeve, pas skadimit të një armëpushimi njëjavor, ka për qëllim shkatërrimin e sunduesit të Gazës, Hamasit, i cili është shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian, pas sulmit të tij në Izrael më 7 tetor, i cili e nxiti dhunën më vdekjeprurëse izraelite-palentineze në dekadat e fundit. Kjo luftë i ka vrarë rreth 15 000

palestinezë tashmë dhe i ka zhvendosur tri të katërtat e popullsisë prej 2.3 milionë të këtij territori, të cilëve nuk po u mbetet ndonjë vend i sigurt për të shkuar. Duket se Izraeli është për ngut për t'ia dhënë Hamasit goditjen përfundimtare - nëse kjo është e mundur, duke i ditur rrënjët e thella të këtij grupi në shoqërinë palestineze - para ndonjë armëpushimi të ri. Bombardimet e kanë shndërruar shumicën e pjesës veriore të Gazës në një djerrinë të mbushur me gërmadha. Rreth 2 milionë njerëz janë zhvendosur tani në pjesën jugore të vendit, e cila ka një hapësirë prej vetëm 230 kilometrash katrorë.



Lufta e Izraelit tani është e përqendruar në jug të Gazës, prandaj ushtria e tij i përsëriti të hënën thirrjet për evakuim të madh, megjithëse nuk është e qartë se ku mund të shkojnë njerëzit tani. Strehimoret janë të stërmëshura tashmë, ndërsa fqinjët Izraeli dhe Egjipti nuk duan të pranojnë palestinezë të Gazës në vendet e tyre. Shtetet e Bashkuara janë duke i bërë trysni Izraelit ta shmangë zhvendosjen masive të njerëzve dhe vrasjen e civilëve. Këtë mesazh e dha zëvendëspresidentja amerikane Kamala Harris gjatë një vizite në këtë rajon.

Gjermania zgjat kontrollat kufitare me Poloninë, Çekinë dhe Zvicrën



Berlin, 4 dhjetor - Gjermania po zgjat kontrollat e përkohshme kufitare me Poloninë, Republikën

Çeke dhe Zvicrën deri më 15 dhjetor, njoftoi të hënën Ministria e Brendshme.

Zakonisht nuk ka kontrolle të rregullta kufitare ose kontrolle dokumentesh në asnjërin prej

kufijve të Gjermanisë pasi të gjitha vendet, duke qenë në zonën Shengen, lëvizin pa viza. Por, në përpjekje për ta ndaluar migrimin e paautorizuar, Gjermania ka rivendosur kontrollat kufitare përgjatë kufijve të saj jugorë dhe lindorë. Një zëdhënës i ministrisë i tha DPA-së të hënën se zgjatja e kontrolleve kufitare do t'i raportohet Komisionit Evropian në Bruksel, por kontrollat pritet të vazhdojnë, veçanërisht përgjatë kufirit gjermano-polak. Ministria e Brendshme, Nancy Faeser, urdhëroi policinë të fillojë të kryejë kontrolle përgjatë kufirit me Poloninë, Republikën Çeke dhe Zvicrën më 16 tetor. Kontrolle të ngjashme përgjatë

kufirit gjermano-austriak kryhen që nga viti 2015. Që nga 16 tetori rreth 3 300 hyrje të paautorizuara janë zbuluar në kufirin me Poloninë dhe 1 100 hyrje të paautorizuara janë parandaluar, tha zëdhënësi. "Kjo do të thotë se këto masa po funksionojnë dhe do të vazhdojnë të veprojnë kështu", tha ai duke shtuar se "nëse dikush kapet në kufi dhe e bën të qartë se dëshiron të aplikojë për azil, ai përgjithësisht lejohet të hyjë në vend". Qëllimi i përgjithshëm i kontrolleve është "ta ndalojë kontrabandën gjithnjë e më të paskrupullt dhe brutale të migrantëve", shtoi zëdhënësi i ministrisë.

Njëmbëdhjetë alpinistë të vdekur dhe dhjetëra të zhdukur pas shpërthimit të vullkanit në Indonezi

MARAPI, 4 DHJETOR - Njëmbëdhjetë alpinistë u gjetën të vdekur të hënën dhe dymbëdhjetë të tjerë ende janë të zhdukur pas shpërthimit të një vullkani në Indonezi. Ekipet e shpëtimit punuan gjatë natës për të gjetur dhjetëra alpinistë të bllokuar në malin Marapi në ishullin Sumatra. Alpinistët e vdekur u gjetën afër kraterit të Marapit pasi vullkani shpërtheu nga maja e malit prej 2 891 metrash dhe hiri u shpërnda në fshatrat e afërta, sipas një zyrtari lokal të shpëtimit. Për pasojë, dymbëdhjetë persona u zhdukën, tre të tjerë u gjetën të gjallë dhe 49 kishin zbritur në mënyrë të sigurt nga krateri. Disa prej tyre ishin me djegie dhe fraktura, tha zyrtari.

"Ne nuk mund të bëjmë kërkim ajror me helikopter, sepse shpërthimi vullkanik po vazhdon", tha shefi i agjencisë lokale të shpëtimit, Abdul Malik. Ai tha se rreth 120 persona ishin të përfshirë në kërkim. Tre personat e tjerë që u gjetën të gjallë nuk kishin zbritur nga mali, siç kishin vepruar të 11 personat që u gjetën të vdekur. Të mbijetuarit u gjetën afër kraterit dhe "gjendja e tyre ishte e dobët dhe disa kishin pësuar djegie", tha Malik. Zhafrah Zahrim Febrina, një nga alpinistët e shpëtuar, shfaqet në një video-mesazh duke i kërkuar ndihmë nënës së saj. Febrina 19-vjeçare është në një spital me babanë dhe xhaxhanë e

saj pasi ishte bllokuar në mal në një udhëtim me 18 shokë të shkollës. "Ajo po kalon një traumë të jashtëzakonshme", tha nëna e saj Rani Radelani, 39 vjeç. "Ajo është e prekur psikologjikisht sepse ka parë djegiet e saj dhe është dashur ta durojë dhimbjen gjithë natën", tha ajo. Zëdhënësi i agjencisë lokale të shpëtimit, Jodi Haryawan, tha se përpjekjet e shpëtimit ishin ndërprerë nga shpërthime sporadike, por kërkimi ishte ende duke vazhduar, pavarësisht prej rreziqeve. "Sapo situata ishte më e sigurt, ata vazhdonin kërkimin. Kështu që kërkimi nuk u ndal", tha ai. Kreu i Agjencisë për Zbutjen e



Fatkeqësive të Sumatrës Perëndimore, Rudy Rinaldi, i tha AFP-së se disa nga alpinistët e shpëtuar kishin pësuar djegie. "Ata që janë lënduar kanë qenë ata që janë afër kraterit", tha ai.

Të paktën tetë persona pësuan djegie, një prej tyre kishte djegie dhe një frakturë dhe një tjetër kishte një plagë në kokë, sipas një liste të atyre që u gjetën nga Basarnas, një agjenci kombëtare e kërkim-shpëtimit.

Prokuroria në Hagë: Do t'i ndjekim të gjithë ata që frikësojnë dëshmitarët

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) në Hagë tha se do t'i hetojë dhe do t'i ndjekë penalisht të gjithë ata që frikësojnë apo ndërhyjnë te dëshmitarët, ose "ofrojnë mbështetje financiare apo të ndonjë forme tjetër për vepra të tilla penale". Reagimi i kësaj zyre vjen pasi trupi gjykues në rastin kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit ka miratuar masat, e kërkuara nga prokuroria, që kufizojnë komunikimet e ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Qendrën e Paraburgimit në Hagë.

Kufizimi, sipas prokurorisë, erdhi si përgjigje për "kërcënimet ndaj integritetit të procesit". "ZPS-ja e ndërmori këtë hap si përgjigje ndaj përpjekjeve për të ndërhyrë te dëshmitarët e për t'i penguar dëshmitë e tyre, dhe kërcënimeve të mëtejshme ndaj integritetit të procesit në çështjen gjyqësore Thaçi dhe të tjerët", deklaroi ZPS përmes një komunikate për medie. Sipas prokurorisë, tre të akuzuarit përdorën vizitat jo të privileguara "për të shpërndarë në mënyrë të paligjshme informacione konfidenciale dhe, në rastin e Thaçit, për t'i instruktuar vizitorët në mënyrë të përsëritur që të kërkojnë t'i

manipulojnë dëshmitë e dëshmitarëve". Kërkesën për kufizim të komunikimeve prokurorja e specializuar e kishte drejtuar javë më parë, ndërsa trupi gjykues kishte marrë vendim të përkohshëm më 17 nëntor të këtij viti. Lidhur me këtë çështje, trupi gjykues ka publikuar vendimin e fundit më 1 dhjetor.

Çfarë vendosi trupi gjykues?

Trupi gjykues, në krye me Charles Smith, vendosi më 1 dhjetor 2023 se vizitat jo të privileguara personalisht për tre të akuzuarit do t'i nënshtrohen miratimit paraprak nga regjistruesi. Trupi gjykues vendosi se "aty ku është e nevojshme, sekretari duhet të konsultohet me ZPS-në për të përcaktuar nëse ka indikacione se një individ i caktuar ka kryer ose mund të angazhohet në sjellje të papajtueshme me kërkesën e tij/saj për një vizitë jo të privileguar te një prej të akuzuarve".

Në vendim thuhet se të akuzuarit mund të kundërshtojnë para Panelit vendimin për të refuzuar një vizitë brenda shtatë ditësh nga njoftimi për refuzim. "Paneli urdhëron që Zyra e Regjistrimit

të sigurojë që: (i) Tre të akuzuarit nuk duhet të takohen me më shumë se një vizitor në çdo kohë (me përjashtim të vizitave nga bashkëshortët/partnerët dhe fëmijët që mund të bëjnë vizita bashkërisht, por pa praninë e ndonjë vizitori tjetër); (ii) zona e vizitës do të jetë pa muzikë ose zhurma të tjera të larta që mund ta dëmtojnë komunikimin e dëgjimit; (iii) i vetmi i paraburgosur me të cilin një vizitor bie në kontakt është i paraburgosuri me të cilin ai [vizitori] është autorizuar për ta vizituar; të paraburgosurit nuk duhet t'u bashkohen vizitave të të paraburgosurve të tjerë; (iv) të paraburgosurit nuk duhet të kenë një vizitor personal jo të privilegjuar në të njëjtën kohë me një të paraburgosur tjetër ose brenda një afërsie të tillë kohore që vizitorët mund të kenë mundësi të ndërveprojnë me njëri-tjetrin ose me të paraburgosurit e tjerë", thuhet në vendim. Trupi gjykues vendosi që të akuzuarit nuk mund të hyjnë në dhomën e vizitave me dokumente apo materiale të natyrës konfidenciale.

Gjithashtu, mori vendim që të gjithë të paraburgosurit dhe vizitorët duhet të komunikojnë me zë dhe nuk lejohen të

komunikojnë fshehtë përmes pëshpëritjes apo gjuhës së koduar.

Veprime të tilla nga të akuzuarit do ta shkaktonin ndërprerjen e parakohshme të vizitës. Trupi gjykues ka theksuar se vetëm avokatët apo bashkavokatët e të akuzuarve kanë të drejtë për vizita të privileguara. Ndërkaq vizitat nga anëtarë të tjerë të ekipit mbrojtës, ku nuk shoqërohen nga avokati apo bashkavokati, nuk janë të privileguara dhe u nënshtrohen kufizimeve, përfshirë miratimin e regjistrimit. "Masat shtesë të kërkuara nga ZPS në lidhje me kufizimet në vizitat me anëtarët e ekipit mbrojtës janë në disproporcion me rrezikun e përfshirë. Paneli nuk ka para vetes informata që do t'i justifikonin masat e tilla. Paneli thekson, për më tepër, se masat e tilla, nëse jepen, mund të kenë efekt të dëmshëm në aftësinë e mbrojtjes për t'u përgatitur. Prandaj, Paneli refuzon t'i miratojë në këtë fazë masat e tjera të kërkuara nga ZPS në lidhje me vizitat nga anëtarët e ekipit të mbrojtjes", thuhet në vendim.

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi si dhe Jakup Krasniqi ndodhen në

paraburgim prej nëntorit të vitit 2020. Gjykimi ndaj tyre ka filluar në prill të këtij viti dhe deri tani kanë dëshmuar 37 dëshmitarë të prokurorisë, ndërsa në total ZPS-ja ka paralajmëruar mbi 300 dëshmitarë në këtë proces gjyqësor.

Prokuroria i akuzon ish-krerët e UÇK-së për vrasje, torturë dhe zhdukje me forcë, ndërsa të gjithë i kanë mohuar akuzat.

Në këtë gjykatë po zhvillohen edhe procese kundër administrimit të drejtësisë, për çka deri tani janë shpallur dy vendime fajësie. Gjatë këtij viti Specialja ka kryer bastisje në Kosovë, disa prej tyre në pronat e ish-këshilltarëve të Thaçit. ZPS-ja ka bërë të ditur se operacionet janë zhvilluar në një proces hetimor që përqendrohet në vepra penale kundër administrimit të drejtësisë. Gjykata në Hagë u krijua pas një raporti të Këshillit të Evropës të vitit 2011, i cili përmbante akuza për trafikim organesh. Themelimi i këtij institucioni u bë më pas nga Kuvendi i Kosovës në gusht të vitit 2015, ndërsa aktakuzat e para u konfirmuan në pjesën e dytë të vitit 2020. Në aktakuzën kundër ish-krerëve të UÇK-së nuk përfshihen akuzat për trafikim organesh.



1 300 gjoba trafiku në 24 orët e fundit në Kosovë

PRISHTINË, 4 DHJETOR - 1 344 gjoba trafiku janë shqiptuar në 24 orët e fundit në vendin tonë. Gjatë kësaj

periudhe kanë ndodhur 15 aksidente me të lënduar dhe 24 me dëme materiale. Në 24 orët e fundit janë

arrestuar 19 persona dhe 14 janë dërguar në mbajtje. Policia e Kosovës ka bërë thirrje për kujdes të shtuar

në komunikacion, duke respektuar normën e shpejtësisë në rrugët e Kosovës.





INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-së SI "ORGANIZATË TERRORISTE"? (11)

Gjeneza e termit 'drejtori politike' e UÇK-së

Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë "Epokës së re", në vazhdimin e pjesës së njëmbëdhjetë, ka folur për gjenezën e termit "drejtori politike" e UÇK-së. Në këtë intervistë ai tregon se nga kush lindi kjo ide dhe kush e përkrahi. Bardhyl Mahmuti, po ashtu, tregon se nga kush e mori besimin që ta përfaqësonte UÇK-në vetë i dyti në një takim me diplomatët amerikanë. "Kërkesë e vetme e ShBA-së ishte që takimi në fjalë të mos bëhej publik nga ana jonë përpara se ta bënin publik amerikanët në momentin kur ta gjykonin të arsyeshëm", ka thënë Bardhyl Mahmuti

PRISHTINË, 4 DHJETOR-
"Epoka e re": LPK-ja krijoi UÇK-në, ndërsa platforma e saj politike për bashkimin e të gjitha forcave politike dhe shoqërore shqiptare, pa dallime klasore, ideologjike, fetare apo krahinore për çlirimin e vendit, u shndërrua në platformë politike të UÇK-së. Si ndodhi që kjo organizatë nuk u shpall "krah politik" i forcës ushtarake që kishte krijuar, por përfaqësimi politik iu ngarkua Drejtorisë

Politike, e cila deri në takimet me diplomatët amerikanë nuk është përmendur asnjëherë?

Bardhyl Mahmuti: Nëse nuk gaboj, në fund të muajit maj 1998, në një takim që pata në Tiranë me Xhavit Halitin dhe një përfaqësues të shtetit shqiptar, emri i të cilit nuk më kujtohet tani, Xhaviti më njoftoi se më ishte besuar ta përfaqësoja UÇK-në në një takim që do të zhvillohej me diplomatët

amerikanë. Kërkesë e vetme e ShBA-së ishte që takimi në fjalë të mos bëhej publik nga ana jonë përpara se ta bënin publik amerikanët në momentin kur ta gjykonin të arsyeshëm. Në të njëjtën kohë më tha se ky takim ishte i një rëndësie të jashtëzakonshme, sepse ishte vendimtar nëse do të na hapeshin rrugët për takime në nivele më të larta shtetërore të ShBA-së, ose do të mbetej në fuqi qëndrimi që cilësohej UÇK-së si "organizatë terroriste".

Mbështetja e shteteve demokratike me peshë në marrëdhëniet ndërkombëtare ishte jetike për realizimin e aspiratave për pavarësi të Kosovës. Isha i vetëdijshëm se dështimi eventual në këtë takim për ta arsyetuar domosdoshmërinë e luftës së armatosur bartte me vete rreziqe të mëdha për UÇK-në.

Kur kërkoja sqarim përse Xhaviti nuk vinte në këtë takim kaq të rëndësishëm, duke pasur parasysh se ishte anëtar i Sektorit

të veçantë të LPK-së që kishte të bënte me aspektin ushtarak, ai më sqaroi se unë duhej të isha "violina e parë" që do të jepte sqarime për çështje të ndryshme politike që u interesonin përfaqësuesve të ShBA-së dhe për këtë arsye komunikimi do të bëhej në gjuhën frënge, të cilën e zotëroja unë. Parimisht nëse bisedimet zhvillohen pa përkthyes, në takime të tilla përfaqësuesit e një delegacioni duhet ta njohin gjuhën në të cilën zhvillohet komunikimi, që të jenë në rrjedhë për tërësinë e asaj që thuhet. Duke pasur parasysh se Xhaviti e fliste gjermanishten, e jo frëngjishten, ai nuk kishte pranuar të merrte pjesë në këtë takim, me qëllim që ta shmange mundësinë të dallonim në përgjigje dhe të ngjallim ndonjë mosbesim, nëse dikush nga anëtarët e delegacionit amerikan i shtronte ndonjë pyetje në gjermanisht. Me një fjalë, të gjitha përgjigjet duhej të ishin në të njëjtat "gjatësi valore". Për këtë arsye Ramadan Avdiu, i cili,

gjithashtu, kishte përfunduar studimet në gjuhën frënge, ishte caktuar të ishte personi i dytë që do ta përfaqësonte UÇK-në në takim me diplomatët amerikanë. Për shkak të shqetësimit se mund të na shtrohej ndonjë pyetje lidhur me çështje që i dinte vetëm Sektorit i veçantë të LPK-së, unë insistova që në takim me diplomatët amerikanë të shkonte Xhaviti me ndonjërin nga anëtarët e tjerë të këtij sektori që njihnte gjermanishten. Të tillë ishin disa. Sugjerimi im nuk u pranua. Mbeti që unë dhe Ramadan Avdiu ta përfaqësonim UÇK-në.

"Epoka e re": A keni biseduar gjatë takimit në Tiranë për gjëra konkrete që do të duhej të thuheshin apo të mos thuheshin në takim me amerikanët?

Bardhyl Mahmuti: Jo! Për asgjë konkrete, sepse askush nuk mund t'i dinte pyetjet që mund të bëheshin nga amerikanët. Më kujtohet se përfaqësuesi i shtetit shqiptar shtroi si hipotezë

mundësinë që të pyeteshim rreth pikëpamjeve ideologjike dhe religjioze të UÇK-së. Kjo ishte e tëra. Na u la në përgjegjësinë tonë të mendonim rreth pyetjeve që mund të shtroheshin dhe përgjigjeve që do të duhej të jepnim.

Takimi me diplomatët amerikanë ishte caktuar të mbahej një javë më vonë në Gjenevë. Të nesërmen udhëtova nga aeroporti i Rinasit për në Zurich dhe prej Zurichut, me tren, për në Vevey, ku banoja. Meqenëse oraret e transportit publik në Zvicër ishin shumë të përpikta, e njoftova Ramadan Avdiun të vinte në orën e caktuar në Vevey.

“Epoka e re”: Si e pritni z. Ramadan Avdiun misionin që u ishte ngarkuar?

Bardhyl Mahmuti : Me tërë seriozitetin që kërkonte kjo çështje. Nga momenti që u njoftua se nuk kishim asgjë konkrete se si mund të zhvillohej biseda, e deri te dita e takimit, punuam me një intensitet të lartë për një numër temash që na e merrte mendja se mund të shtroheshin nga diplomatët amerikanë.

“Epoka e re”: Kur u kthyet në Zvicër a e njoftuat Kryesinë e LPK-së, nënkryetar i së cilës ishte, për takimin që pritej të mbahej në Gjenevë dhe faktin se ju dhe z. Ramadan Avdiu ishit caktuar ta përfaqësonit UÇK-në?

Bardhyl Mahmuti: Kërkesa e ShBA-së ishte që, përveç

ndërmjetësuesve të shtetit shqiptar, askush nuk duhej të vihej në dijeni për këtë takim. Një kërkesë e tillë lidhej me faktin se në rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të cilat ishin miratuar pa asnjë votë kundër, UÇK-ja cilësohej si “organizatë terroriste”. Takimi me një organizatë “të tillë” pa u hequr ky cilësim mund të nxiste reagime të panevojshme kundër ShBA-së dhe ta dëmtonte vendosjen e komunikimit të drejtpërdrejtë me ne. Për t’i shmangur përgjigjeve eventuale nga shërbimet e huaja, ata kishin përcaktuar datën, vendin dhe orën e takimit. Prandaj nuk njoftuam askënd për këtë takim, as bashkëveprimtarët te të cilët kishim besim të plotë.

“Epoka e re”: Për aq sa jemi në dijeni, në kuadër të organeve drejtuese të LPK-së disa herë është shtruar çështja e drejtimit politik të UÇK-së?

Bardhyl Mahmuti: Në kuadër të Këshillit të Përgjithshëm të LPK-së disa herë ishte shtruar kërkesa që LPK-ja të shpallej “krah politik” i UÇK-së. Mirëpo një kërkesë e tillë asnjëherë nuk gjeti mbështetjen e shumicës së anëtarëve të organeve drejtuese të LPK-së. Në kuadër të debateve të atëhershme brenda nesh mbizotëronte qëndrimi se ta kërkojmë bashkimin e të gjitha forcave politike dhe shoqërore kombëtare në mbështetje të luftës së armatosur dhe të mbash

për vete të drejtën për ta përfaqësuar politikisht këtë luftë jo vetëm që nuk do të gjente mbështetjen e asnjë partie politike, por do të ishte pengesë për realizimin e një qëllimi të tillë.

I vetëdijshëm se çështja e drejtimit politik të UÇK-së do të shtrohej në takim me amerikanët, kërkoja mendimin e Xhavitit. Përgjigja e Xhavitit ishte më shumë diplomatike sesa një përgjigje konkrete: “Ti dhe Ramadan Avdiu jeni politologë që keni përfunduar studimet në shtetet demokratike dhe nuk mund t’ju mësoj unë se çfarë duhet të thoni në takim me amerikanët. Rezultati pozitiv ose negativ varet nga mënyra si do t’i shtroni gjërat ju”.

“Epoka e re”: A kishit frikë se dështimi eventual në takim me diplomatët amerikanë do të kishte pasojë për reputacionin tuaj dhe mund të fajësohej se “për shkakun tuaj UÇK-së nuk iu hoq cilësimi i organizatës terroriste”?

Bardhyl Mahmuti: Me Ramadan Avdiun njihesha që nga muaji shtator i vitit 1984, kur e sollën nga Burgu i Qarkut në Prishtinë, në Burgun “Zabela” në Pozharevac. Në muajin nëntor të vitit 1986 na transferuan të dy në Burgun e Qarkut në Shabac dhe, në fund, në qershor të vitit 1987, na transferuan në Burgun e Qarkut në Zajëçar, ku qëndrova bashkë me të deri në gusht të vitit 1988.

Në të kaluarën ishim ballafaquar me situata ku pasojat e gabimeve të tona i “paguanim” personalisht secili prej nesh. Mirëpo konteksti ku fjalët që do të thoshim ne ishin përcaktuese për qëndrimin e ShBA-së ndaj luftës sonë çlirimtare, në vinte përpara një sfida me përgjegjësi që nuk e kisha pasur asnjëherë më parë: nëse nuk do të hiqej cilësimi i UÇK-së si “organizatë terroriste”, edhe të tjerët do ta paguanin çmimin e gabimeve tona.

Për ne ishte jetike të hiqej cilësimi jo i drejtë i UÇK-së, sepse hapte rrugë për legjitimitimin e luftës sonë çlirimtare dhe përkrahjen e saj. Me Ramadan Avdiun vinim nga e njëjta shkollë e shkencave politike (Universiteti i Lozanës) dhe për asnjë çast nuk i kemi menduar pasojat personale në rast dështimi, për arsye se përqendrimi në pasojat shndërrohet në ankth që paralizon të menduarit!

Në kuadër të përpilimit të strategjisë që përgjigjet tona të ishin tërësisht koherente pavarësisht prej temave që dilnin, lindi edhe çështja se si do të përgjigjeshim lidhur me atë se kush udhëhiqte politikisht UÇK-në. Në diskutim rreth kësaj teme lindi ideja e termit “drejtori politik”.

“Epoka e re”: A u konsultuat edhe me dikë tjetër për termin “drejtori politik”, apo për një gjë të tillë vendosët vetëm ju dy?

Bardhyl Mahmuti: Meqenëse takimi me diplomatët amerikanë

duhej të mbetej në konfidencë, vendosëm ta kërkonim mendimin e Bedri Islamit, që ishte kryetar i LPK-së, Jashar Salihut, Bilall Sherifit dhe të Agush Bujës, me të cilët kishim mbajtur disa konferenca shtypi në Selinë e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë, por pa u thënë arsytet e shtrimit të kësaj çështjeje. Nga frika e përgjimeve të telefonave nuk i pyetëm drejtuesit e tjerë të LPK-së që ishin në shtete të tjera.

“Epoka e re”: Cili ishte qëndrimi i tyre?

Bardhyl Mahmuti: Të gjithë ishin të mendimit se termi “drejtori politik” hapte mundësinë e përfshirjes së spektrit të gjerë të forcave politike shqiptare në mbështetje të UÇK-së dhe ishte i zhveshur nga konotacione partiake apo ideologjike.

“Epoka e re”: Me sa shihet nga ajo që thatë më lart, takimi me diplomatët amerikanë krijoi një dinamikë të re të debateve rreth drejtimit politik të luftës së armatosur në Kosovë.

Bardhyl Mahmuti: Konstatim i drejtë! Nëse takimi do të kishte rezultate pozitive, tërësia e veprimeve diplomatike dhe mediatike e UÇK-së do të merrte një intensitet të pakrahasueshëm me periudhën paraprake. Në këto rrethana, organizimi në drejtori të sektorëve të ndryshëm dilte si domosdoshmëri.

(Muhamet Mavraj / Vijon)



Rivarrosot trupi i Liridona Ademajt, familja hap të pame në fshatin Rracaj

GJAKOVË, 4 DHJETOR - Në fshatin Rracaj të Gjakovës të hënën është bërë rivarrimi i turpit të Liridona Ademajt e cila është vrarë mbrëmjen e 29 nëntorit në Prishtinë. Ajo me kërkesë të familjes është zhvarrosur nga varrezat e fshatit Cërmjan. Në ceremoninë e rivarrimit kanë marrë pjesë edhe

ministri i Brendshëm, Xhelal Sveçla, ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ministrja Rozeta Hajdari dhe ministrja Donika Gërvalla. Të pranishëm kanë qenë edhe deputetë dhe qytetarë të shumtë. Familjarët e Liridona Ademajt kanë hapur të pame në fshatin

Rracaj. Për vrasjen e Liridona Ademajt janë arrestuar tre persona ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit prej 30-ditësh. Në mesin e tyre është edhe bashkëshorti i saj, Naim Murseli, i cili dyshohet se ka orkestruar vrasjen e bashkëshortes.



Hasani: Rezoluta 1244 dhe Arbitrazhi, ndër pikat e kuqe në draft-statutin për Asociacionin

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Enver Hasani, ka thënë se draft-statuti i hartuar prej Perëndimit për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë krijon autonomi politiko-territoriale me kompetenca të theksuara shtetërore. Në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", ai ka thënë se nuk do të thotë që dokumenti bëhet kushtetues vetëm pse mund të dërgohet në Gjykatën Kushtetuese. Ai e përmend se draftet për Asociacionin do të duhej të ishin në përputhje me aktgjykimin e vitit 2015 të Gjykatës Kushtetuese, mirëpo drafti aktual nuk e ka marrë atë fare për bazë, duke e përjashtuar nga preambula. Hasani e ka përmendur si mundësi edhe ndryshimin e aktgjykimit të vitit 2015, ndonëse ka sqaruar se diçka e tillë mund të bëhet vetëm duke u bazuar në kriteret jashtë Kushtetutës: politike, sociologjike, morale. "Radio Evropa e Lirë" ka pasur qasje në draft-statut, përmbajtja e të cilit është konfirmuar nga disa burime të REL-it në Bruksel. Qeveria e Kosovës nuk e ka komentuar për vërtetësinë e tij. "Kjo përmbajtje e këtij statuti është derivat i drejtpërdrejtë i Marrëveshjes së Brukselit, përkatësisht aneksit të Ohrit. Do të thotë, është i dedikuar për zbatimin e një autonomie politiko-territoriale, e cila ka autorizime të theksuara kushtetuese, përmbajtje shtetërore. Pjesa e kompetencave, që ka të bëjë me zhvillimin ekonomik, kulturor, përfaqësimin politik, të gjitha ato janë përgjegjësi të Republikës së



Kosovës dhe përgjegjësi me Kushtetutë, sikurse në të gjitha vendet e tjera të rajonit, dhe tani ato kompetenca i uzurpon Asociacioni. Mbi këtë bazë, kjo është tërësisht Kushtetutë e re, bëhet fjalë për shkrimin e një Kushtetute të dytë të Kosovës, që vlen vetëm për serbët", ka thënë Hasani. Ai ka thënë se fakti që shkon në Gjykatën Kushtetuese nuk do të thotë që është kushtetues, për shkak se, për të qenë kushtetues, në statut do të duhej ta kishte si bazë aktgjykimin e vitit 2015, jo Rezolutën 1244 dhe, përveç Rezolutës, të citohet në preambulë, dhe më vonë në tekst, Karta Evropiane, në mënyrë fiktive, komplet fiktive. "Ato nene kanë të bëjnë me autonomi me komunat, me pushtetin lokal dhe

jo me politikën ekonomiko-territoriale që i rregullon statuti aty. Për të qenë sipas Kushtetutës, do të duhej ta kishte parametër aktgjykimin e vitit 2015. Ai aktgjykim është eliminuar, nuk ekziston në preambulën e statutit. Prandaj, gjykata nuk ka kompetencë ta bëjë vlerësimin e përmbajtjes, kushtetutshmërisë së statutit të një entiteti tjetër, jashtë atij që ekziston në Kushtetutë", ka thënë Hasani. I pyetur se çfarë saktësisht është kundërkushtetuese në atë draft, Hasani është përgjigjur: "Enver Hasani: Fund e krye. Prej preambulës, e cila përmend Rezolutën 1244, e cila garanton integritetin territorial të Serbisë, Kushtetuta e Kosovës përmendet në mënyrë fiktive. Në bazë të cilave dispozita caktohet statuti? Nuk

përmenden. Merreni dhe shikojeni Kartën Evropiane. Flet për arsim privat. Nuk bëhet fjalë për arsim privat, por për arsimin e Serbisë në Kosovë, dhe pse është futur aty dispozita se bëhet prej agjencive private, është për shkak se Serbia nuk pranon që arsimi dhe shëndetësia - që ajo e financon dhe krijon në territorin e Kosovës, të jetë në autoritetin e Republikës së Kosovës, të cilën ajo nuk e njeh. Për pasojë, janë komisionuar këto dy agjenci, por diplomat, dokumentet e fundit, e kanë vulën apostile të shtetit të Serbisë. Kjo është kundër sovranitetit dhe pavarësisë së Kosovës". Hasani ka folur edhe për rreziqet e këtij dokumenti. "Rreziku kryesor është se ky dokument nuk krijon nivel as të tretë, as të katërt të pushtetit, është

pushtet paralel si në aspektin horizontal, ashtu në atë vertikal. Në aspektin horizontal, ky pushtet që i krijon organet, Kuvendin, organin ekzekutiv dhe çështje të sigurisë, caktimin e policëve ku janë komunat serbe, e bën ndarjen e punës - dokumenti, jo Kushtetuta e Kosovës. Në aspektin vertikal, Asociacioni paraqitet si përfaqësues i komunave, i autonomisë serbe në raport me pushtetin qendror dhe me operatorët ekonomikë, institucionet shtetërore të vendeve fqinje, vendeve të jashtme, paraqitet ky. Në prona, shembull, të gjitha pronat shndërron në prona të Asociacionit në momentin që themelohet. Ujmani, pjesë të Trepçës, dikur që kanë qenë, gjithçka që nuk është private në territorin e këtyre komunave, bartet në këtë Asociacion. E dyta. Ky është 'self-contained', regjim i mbyllur, jo i hapur. Dhe për këtë është dëshmi mënyra e zgjedhjes së mosmarrëveshjeve - për interpretim të statutit, caktohet Arbitrazhi. Për interpretim të statutit dhe zbatim të tij nuk është Gjykata Kushtetuese më, gjithçka që ka për interpretim merret vetëm kur të formohet, më pas ajo mund t'i vlerësojë amendamentet, por jo përmbajtjen. Ky Asociacion është etnik dhe çka është edhe më e keqe, krijon një super kategori të komunitetit etnik, që është komuniteti serb, i cili i ruan privilegjet në nivel qendror, sipas Kushtetutës së Kosovës, por edhe në raport me krejt komunitetet, përfshirë edhe shqiptarët, ka të drejta shtesë, që i realizon sipas mënyrës që ai e përcakton, me këtë statut", ka theksuar Hasani.

Pjesëtarë të FSK-së marrin pjesë në trajnimin Kërkim-Shpëtim Urban në Zvicër

Prishtinë, 4 dhjetor - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci ka njoftuar se pjesëtarë të FSK-së kanë marrë pjesë në trajnimin e organizuar në Zvicër. Maqedonci thotë se ata për pesë ditë kanë zhvilluar trajnimin "Kërkim-Shpëtim Urban". "Përkrah ekipeve të kërkim-shpëtimit nga Mbretëria e Bashkuar, Spanja dhe Franca, pesë pjesëtarë të FSK-së të


Qendrës Ndërkombëtare të Kërkim-Shpëtimit të Gardës Kombëtare, me ftesë të Ekipit Ndërkombëtar të Kërkim-Shpëtimit të Mbretërisë së Bashkuar, dhe me aprovimin e Ekipit të Kërkim-Shpëtimit të Kombeve të Bashkuara, morën pjesë në trajnimin e organizuar në Zvicër, ku për pesë ditë me radhë zhvilluan trajnimin Kërkim-Shpëtim Urban", ka shkruar ministri

në "Facebook". Më tutje ministri ka deklaruar se "pjesëtarët tanë edhe një herë treguan shkallë të lartë profesionalizmi duke dëshmuar kësajsoj potencialin e jashtëzakonshëm që ekziston brenda QNTKSH për t'u shndërruar në qendër të njohur ndërkombëtarisht në fushën e kërkim-shpëtimit, me Kosovën shtet pritës".



52 gra të vrara për 13 vjet në Kosovë

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Nga viti 2010 deri në nëntorin e vitit 2023 në Kosovë janë vrarë 52 gra. Organizatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në disa raste kanë fajësuar autoritetet për dështim në mbrojtjen e grave të rrezikuara nga dhuna. Në të shumtën e rasteve, autorë të vrasjeve kanë qenë bashkëshortët, pastaj baballarët dhe djemtë. Rasti i fundit që u organizua vrasja nga bashkëshorti ishte i Liridona Ademajt. Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka thënë se vrasësit e Liridonës duhet ta marrin dënimin e merituar. "Ky rast duhet ta marrë dënimin e merituar nga institucionet tona të drejtësisë. Rasti që ndodhi para pak ditësh është dëshmi se kemi ende shumë punë për të bërë. Të gjitha institucionet duhet të jenë në krye të detyrës. Askush në Republikën e Kosovës nuk ka të drejtë ta cenojë dinjitetin e



askujt", ka thënë Haxhiu.

Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar masë paraburgimi prej një muaji ndaj tre të dyshuarve me inicialet N. M., G. P. dhe K. K., për vrasjen e Liridona Murselit. N. M. për shkak të veprës penale vrasje e rëndë në bashkëkryerje, G. P. për veprën penale vrasje e rëndë dhe mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, dhe K. K. për shkak të veprës penale marrëveshje për ta kryer veprën penale vrasje e rëndë. Liridona është vrarë më 29 nëntor në Prishtinë. Në mesin e të dyshuarve për vrasjen e 30-vjeçares është edhe burri i saj, Naim Murseli. Gjykata e ka marrë vendimin pas një seance dëgjimore që e ka mbajtur të dielën për këtë rast. Vrasja e Liridona Ademajt i ka tronditur qytetarët e kryeqytetit. Madje ata thonë se lajmi për vrasjen e saj ka qenë më i kobshmi kohët e fundit. Dënim

maksimal po kërkojnë ata për të gjithë personat e përfshirë në vrasjen e 30-vjeçares, duke kërkuar edhe ndryshimin e ligjeve. "Kjo vrasje është makabër. Kjo është diçka, mos të them, e padëgjuar me vra bashkëshorten për pare për sigurim qysh po thonë me vra nënën e fëmijëve me vra një person që ka zgjedh me jetuar vetë. Kjo është tmerr. Na ka tmerruar të gjithëve me të vërtetë", ka thënë për "Ekonomia Online" Kemail Islami. Hajrush Fazliu tha se duhet të bëhen ndryshime ligjore në mënyrë që të ashpërsohen dënimet për këto vepra penale. "Është diçka çnjerëzore. Kriminelët duhet ta marrin vërtet gjykimin më meritore. Të vritet një zonjë, një nënë e fëmijëve, të vritet një e ardhme e këtij shteti, vërtet është për të çuditur. Ka ardhur momenti që qeveria, parlamenti të marrin vendime që të ndërrohen kodet e ligjeve për vrasje të tilla", ka thënë ai.

Sejdiu: Opozita pa kualitet, Abdixhiku, kryetar i LDK-së me qasje të parregullt

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Ish-presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu, e sheh me rëndësi të jashtëzakonshme unitetin politik për t'u përballur me sfidat e shtetndërtimit. Ai në një intervistë dhënë për "Kosovalive" tha se që në kohën e bisedimeve të Vjenës kishin unitet të plotë, pozitë dhe opozitë duke qenë kështu të bashkuar në një proces të vështirë të negociatave. Sejdiu e kujton një moment të rëndësishëm më të dërguarin amerikan tashmë të ndjerë Frank Wisner, kur ky i kishte bërë një pyetje: A mund të qëndroni deri në fund me argumentet për pavarësinë e Kosovës? Ishte një pyetje direkte, tha Sejdiu, duke e krahasuar atë situatë me gjendjen e tashme që po përballet Kosova jo vetëm me Serbinë, por edhe me faktorë të tjerë që nuk janë në anën e Kosovës. Ish-presidenti e ftoi klasën politike të jetë e përgjegjshme, siç tha, në rastet kur propozojnë ide për konferenca ndërkombëtare për Kosovën e ide të tjera. Sipas tij, këto ide shkojnë në dëm të 17 shkurtit 2008, po ashtu edhe të

vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Sejdiu e sheh me rëndësi që pushteti ta ftojë opozitën për ta ndërtuar unitetin, por jo vetëm. Në rrethanat politike që po kalon Kosova, sipas tij, është e rëndësishme të angazhohen edhe institute për të bërë analiza dhe studime të secilës situatë. Ish-kryetari i LDK-së, Fatmir Sejdiu, që e mori drejtimin e partisë pas vdekjes së Ibrahim Rugovës, nuk është i impresionuar me mënyrën e zgjedhjeve në Kuvendin Zgjedhor të LDK-së, ku u konfirmua për kryetar për katër vitet e ardhshme Lumir Abdixhiku. "Ai e ka marrë besimin në Kuvend me krejt votat që i ka dhënë. Nuk mendoj se ka qenë qasje e rregullt, që nuk është lejuar mundësia që të ketë edhe kandidat tjetër. Ky është mendimi im. Fitoj apo nuk fitoj", tha Sejdiu. Ish-presidenti Sejdiu nuk foli me emra për të vlerësuar se cili nga liderët opozitarë po e bën apo jo detyrën aktive në raport me pushtetin kur vendi po përballet me një proces kritik të bisedimeve me Serbinë, po ashtu edhe për temat e brendshme.



"Nuk ndalem tek individët, por unë shoh se konceptualisht nuk është prezantuar ID-ja apo ai identitet që duhet ta ketë një opozitë. Natyrisht se mund të jetë edhe në mungesë të numrave,

por kualiteti s'do të thotë që të mos jetë prezent në kuptimin e asaj që paraqet, tha ai. Kualitet nuk shihni? "Nuk shoh, absolutisht nuk shoh kualitet në atë që mund të jetë e nevojshme

edhe për kohën në kuptimin e reagimit. Më duket shumë e paarsyeshme edhe ajo pjesa e takimeve me faktorin ndërkombëtar, me Lajçakun", është përgjigjur Sejdiu.

Haziri: Një lloj konfederate po kërcënon të krijohet në Kosovë

Prishtinë, 4 dhjetor - Nën-kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), njëkohësisht i ngarkuar për dialogun nga partia e tij, Lutfi Haziri, mendon se një lloj konfederate po kërcënon të krijohet dhe se Kosova e shtyn kështu njohjen nga Serbia edhe më shumë në kohë. "Ne atëherë kemi paralajmëruar shqetësimin tonë sepse është degraduar nga një

marrëveshje obligativisht ligjore me njohjen në qendër si një qëllim kryesor në një marrëveshje të përkohshme, ku njohja e Kosovës nga Serbia shtyhet. Ky dokument nuk ka dalë jashtë asaj kornize. Në vete parasheh mënyrën specifike dhe detyrat, kompetencat, të veçantat e katër komunave në veri. Më së paku mund të flasim për ndarje të brendshme, ne dhe ata, në një

Kosovë në parime të njëjta të multietnicitetit, të territorit, të sovranitetit. Në fakt, po krijohet pushteti i tretë në këtë rrafsh si lexim i parë. Si lexim në implementim kur të bëhet akti i kryer. Janë disa çështje që Kosovës mund t'ia pasqyrojnë një Kosovë të vogël serbe brenda territorit tonë. Si do ta quajmë të tjerët, mund të vërehet një lloj konfederate", ka pohuar Haziri për A2 CNN.



Bizneset shqiptare në Zvicër hapin dyert për kosovarët

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Bizneset me pronarë nga Kosova që veprojnë në Zvicër kanë paralajmëruar punësimin e qytetarëve nga Kosova gjatë muajve në vijim. Përfaqësues të tyre kanë thënë se me heqjen e vizave të rinjtë do të kenë më shumë mundësi për të udhëtuar e për të krijuar bashkëpunim me bizneset e huaja. Një pjesë e bizneseve që veprojnë në Zvicër po synojnë rekrutimin e punëtorëve nga Kosova. "Ne kemi shumë shpresë se pas 1 janarit legjislacioni zviceran do të hapë dyert për punëtorët nga Kosova në mënyrë që të rinjtë dhe të rejtat

kosovare të vijnë dhe të angazhohen në bizneset tona", ka deklaruar për RTK-në përfaqësuesi i konsullatës së Kosovës në Gjenevë, Rexhep Bajraktari. Pronarët e tyre të cilët, po ashtu, vendlindje e kanë Kosovën, thonë se pas 1 janarit të rinjtë do të kenë më shumë mundësi për të udhëtuar e për t'u njoftuar me punët që bëhen jashtë. Ndërkaq, disa përfaqësues të bizneseve në Kosovë thonë se po punojnë për përmirësimin e kushteve të punës dhe rritjen e pagave për ta ruajtur stafin. Të dhënat e Agjencisë së

Statistikave të Kosovës tregojnë se një numër i madh i qytetarëve kanë emigruar jashtë vendit ndër vite. Mediet zvicerane raportojnë se mbi 200 mijë kosovarë jetojnë vetëm në Zvicër. Ministria e Jashtme ka organizuar të shtunën një aktivitet në Gjenevë për ta rritur më shumë bashkëpunimin mes bizneseve që veprojnë në Kosovë dhe Zvicër. Për shkak të kushteve jo të mira të punës e pagave të ulëta, përfaqësues të punëtorëve të sektorit privat kanë thënë se mijëra punëtorë kanë lëshuar punën këtë vit.



Rreth 80 mijë euro obligime ndaj minatorëve, Sindikata i jep një javë kohë menaxhmentit të "Trepçës"

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Trepçës përmes një reagimi publik thotë se menaxhmenti i ndërmarrjes "Trepça" ka rreth 80 mijë euro obligime ndaj tyre. Sindikalistët fajësojnë menaxhmentin se po pengon aktivitetet e tyre dhe se shuma rreth 80 mijë euro është që minatorët kanë paguar nga paga e tyre. "Të nderuar minator janë bërë tani e sa vite që Menaxhmenti i Ndërmarrjes Trepça Sh.A e pengon aktivitetin sindikal të Sindikatës së minatorëve të Kosovës në forma të ndryshme, duke filluar nga përndjekjet, shantazhet, presionet, kërcënimet, suspendimet, largimet nga puna etj. Një formë tjetër pengimit të veprimit sindikal dhe përpjekjes për të zhbërë sindikatën është ndalesa e kuotizimit apo anëtarësisë sindikale. Duke penguar dhe pamundësuar aktivitetin sindikal vazhdimisht. Si rezultat i mosttransferimit të këtyre mjeteve për disa vite obligimi tanimë duhet të jetë rreth 80.000



mijë euro. E tmerrshme. Këto janë paga jonë, me djersën e ballit dhe mjete të cilat ne i paguajmë nga të njëjtat nuk na i transferojnë në llogarinë sindikale, me tendencën e vetme përndjekjen e

sindikalistëve, largimin e tyre nga sindikata dhe njëherësh zhbërjen e saj", theksohet në reagim. Tutje ata thonë: "Turpi ju mbuloftë. Ju se keni idenë se çka është as demokratike e as ligjore. Por ta dini se Trepça nuk është pronë e bordit e as e një menaxhmenti total të padijshëm. Trepça Sh.A para së gjithash është e minatorëve dhe qytetarëve, e kështu do të mbetet gjithmonë". Sindikata ka kërkuar nga menaxhmenti që brenda një jave të realizojnë vlerën prej 80 mijë euro. "Ne ju njoftojmë dhe bëjmë thirrje që nëse brenda afatit një javor nuk paguhet vlera e plotë e kuotizimit sindikal (që është paguar nga djersa jonë/ nga gjepi ynë/ nga kafshata e familjeve tonë), ne do të ndërmarrim të gjithë hapat demokratik për të realizuar këtë të drejtë. Bashkangjitur me këtë postim keni vetëm një pjesë të obligimeve që ndërmarrja Trepça Sh.A i ka Sindikatës së Pavarur të Minatorëve të Trepçës së Kosovës", përfundon reagimi.

Komuna e Prishtinës merr vendim të enjten për faljen e borxhit të tatimit në pronë

Prishtinë, 4 dhjetor - Komuna e Prishtinës të enjten e 7 dhjetorit do të marrë vendim për çështjen e faljes së 100 eurove të tatimit në provë. Lajmin për "Albanian Post" e ka konfirmuar zëdhënësjja e komunës së Prishtinës, Arlinda Kastrati, e cila ka sqaruar se për këtë çështje do të mbahet seancë e jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal. "Për faljen e borxhit të tatimit në pronë duhet të merret vendim nga Kuvendi Komunal, rrjedhimisht kryeqyteti ka caktuar mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme me datë 7.12.2023. pikë e rendit të ditës do të jetë vetëm propozim-vendimi për faljen e tatimit në pronë për pronën e paluajtshme për vitin




tatimor 2023", ka thënë Kastrati. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve i ka njoftuar komunat se kanë afat deri më 8 dhjetor për të vendosur lidhur me faljen e tatimit në pronë deri në vlerën

prej 100 eurove. Përmes një komunikate për medie nga ministria është thënë se Kushtetuesja i ka dhënë të drejtë Ministrisë për faljen e tatimit, prandaj ua ka lënë në dorë

komunave për të vendosur. "Pas publikimit të Aktgjykimit të AGJ 2296/23 më datë 23.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve i ka njoftuar Komunat e Republikës së Kosovës për përmbytjen e Aktgjykimit si dhe për afatin e përcaktuar nga Gjykata për zbatimin e dispozitës ligjore për faljen e tatimit në pronë për vitin 2023 deri në vlerën prej 100 euro. Si rrjedhojë, komunat e Republikës së Kosovës janë njoftuar se deri më datën 08.12.2023 mund të vendosin rreth faljes së tatimit në pronë e cila mund të lejohet deri në lartësinë e faturës së tatimit në

pronë për vitin 2023, por jo më shumë se njëqind (100) euro", thuhet në njoftimin e MF-së. Gjykata Kushtetuese më 23 nëntor i ka dhënë të drejtë Ministrisë së Financave për faljen e tatimit në pronë deri në 100 euro për vitin 2023, por ua ka lënë në dorë komunave veç e veç për të vendosur. Tatimpaguesit e komunës, e cila e merr këtë vendim, "do të përfitojnë nga falja deri në lartësinë e faturës së tatimit në pronë për vitin 2023, por jo më shumë se njëqind (100) euro". Ata të cilët e kanë paguar tatimin në pronë për vitin 2023, sipas njoftimit, shuma e falur i llogaritet si paradhënie për vitet pasuese.

Letra e Haksliit për Oruellin (1949): Vizioni im për ferrin e së ardhmes është më i saktë se i yti!



Përktheu dhe përgatiti:
Agron SHALÀ

Pasi e lexon veprën 1984 (Nineteen Eighty-Four), Oldus Haksli (Aldous Huxley) – autori i fantashkencës së famshme distopike Brave New World (1932), që në shqip është përkthyer si Më e mira e botëve – ia dërgon një letër Xhorxh Oruellit (George Orwell) të cilin e kishte student në Kolegjin Iton. Haksli e çmon veprën e Oruellit, pajtohet me vlerësimet pozitive të kritikëve, por shton se më i saktë është parashikimi i tij për skëterrën e së ardhmes.

Nëse Oruelli kishte të drejtë dikur, mund të thuhet se Haksli ka më shumë të drejtë për të realitetin e sotëm. Sepse, përderisa në diktaturën komuniste përmes survejimit, gënjeshtreve e izolimit populli mashtrohej për realitetin brenda dhe jashtë sistemit – me atë që njihet si botë oruelliane – në demokraci kjo bëhet ndryshe: përmes mediave sociale dhe “bombardimit” me lajme – apo botës haksliane. Oruelli paralajmëronte se njerëzit do të kaplohen nga shtypja e jashtme, Haksli parashikonte se njerëzit do ta shtypin veten duke adhuruar teknologjitë që zhbëjnë kapacitetet e të menduarit; Oruelli kishte frikë nga ata që do të ndalonin librat, por Haksli kishte frikë se nuk do të ketë nevojë që të ndalohen ato – pasi askush nuk do të dojë t’i lexojë; Oruelli kishte frikë se e vërteta do të fshihej, Haksli kishte frikë se ajo do të hidhej në detin e parëndësishë...

Letrën e shkruar më 21 tetor 1949, mund ta lexoni të plotë më poshtë:

Pjesë nga letra e Haksliit, drejtuar Oruellit

I dashur z. Oruell [George Orwell],

Qe gjest shumë i mirë nga ana jote, që botuesve u the të ma dërgonin një kopje të librit tënd. Mbërriti kur isha në mes të një pune që kërkonte shumë lexime dhe shumë konsultime të referencave; dhe, meqenëse shikimi im i dobët e bën të domosdoshëm pakësimin e leximit, për një kohë të gjatë më duhej të prisja – para se të mund t’ia filloja me 1984-shin.

Duke u pajtuar me gjithçka që kritikët kanë shkruar për të, nuk kam nevojë të ta them – edhe një herë – se sa i mirë dhe se sa i thellë është libri. Në vend të kësaj, a mund të flas për një gjë që libri trajton – revolucionin përfundimtar?[1] Lëvizjet e para të filozofisë së revolucionit përfundimtar – të revolucionit që shtrihet përtej politikës dhe ekonomisë dhe që synon përmbyshjen e plotë të psikologjisë dhe të fiziologjisë së individit – gjenden te Markez de Sadi [Marquis de Sade] që veten e konsideronte si pasues, në çdo detaj, të Robespierit [Maximilien Robespierre] dhe të Babeftit [François-Noël Babeuf].[2] Filozofia e pakicës sunduese, në 1984, është sadizmi që bartet deri në përfundimin e vet logjik që kapërcen dhe mohan seksin. Duket e dyshimtë nëse, në

realitetin aktual, pafundësisht mund të vazhdojë politika e përplasjes së çizmeve në fytyrë.[3] Besimi im është se oligarkia sunduese do të gjejë mënyra më pak të mundimshme dhe më pak të dështuara për të qeverisur dhe për ta kënaqur epshin e vet për pushtet, dhe këto mënyra do të ngjajnë me gjërat që përshkrova te Më e mira e botëve. Tash së voni pata rastin të analizoja historinë e magnetizmit kafshëror dhe të hipnotizmit dhe së tepërmi jam befasuar nga mënyra me të cilën bota, për njëqind e pesëdhjetë vjet, ka refuzuar të njoh seriozisht zbulimet e Mesmerit [Franz Mesmer], Brejdit [James Braid], Ezdejlit [James Esdaile] dhe të tjerëve.[4]

Pjesërisht për shkak të mbisundimit të materializmit dhe pjesërisht për shkak të mbisundimit të parimeve të sjelljes, filozofët dhe njerëzit e shkencës së shekullit të nëntëmbëdhjetë nuk ishin të gatshëm që për njeriun praktik – si politikanët, ushtarët dhe policët – t’i hetojnë faktet e çuditshme të psikologjisë së njerëzve, për t’i aplikuar pastaj ato në fushën e qeverisjes. Falë injorancës së qëllimshme të baballarëve tanë, mbërritja e revolucionit përfundimtar u shty për pesë ose gjashtë breza. Një rastësi tjetër fatlume ishte paaftësia e Frojdit [Sigmund Freud] për të hipnotizuar me sukses dhe pastaj përçmimi i tij ndaj hipnozës.[5] Për të paktën dyzet vjet kjo e vonoi zbatimin e përgjithshëm të hipnozës në psikiatri. Por, psikanaliza tash po kombinohet

me hipnozën; dhe, hipnoza është bërë më e lehtë dhe zgjat deri në kohë të pacaktuar nëpërmjet përdorimit të barbiturateve të cilat edhe te subjektet më të pabindura shkaktojnë gjendje hipnotike dhe sugjestive. Besoj se brenda brezit të ardhshëm, sundimtarët e botës do të zbulojnë se kushtëzimi i foshnjave dhe narko-hipnoza janë instrumente më efikase të qeverisjes sesa klubet dhe burgjet, dhe se epshi për pushtet pothuajse tërësisht mund të përbushet duke ua sugjeruar njerëzve rëniën në dashuri me robërinë e vet – po aq njëjtë sikurse përmes fshikullimit dhe shkelmimit derisa të binden. Me fjalë të tjera, ndjej se makthi i 1984-shit është i paracaktuar për t’u shndërruar në makthin e një bote që ka më shumë ngjashmëri me atë që unë e kam paramenduar te Më e mira e botëve. Ndryshimi do të ndodhë si rezultat i ndjesisë për nevojën për të shtuar efikasitetin. Me siguri, në ndërkohë mund të ketë luftë biologjike dhe atomike të shkallës së gjerë – në këtë rast do të kemi makthe të tjera dhe të llojeve që më me vështirësi mund të paramendohen.

Edhe një herë të falënderoj për librin.

Sinqerisht,
I yti, Oldus Haksli

[1] Revolucionin Përfundimtar [The Ultimate Revolution] për të cilin ka shkruar Haksli ka të bëjë me zhvillimin e kontrolleve të reja të sjelljes, të cilat drejtpërdrejt veprojnë në organizmat

psiko-fiziologjikë të njeriut. Kjo është aftësia për të zëvendësuar kufizimet e jashtme me shtrëngime të brendshme. [shën. i përkth]

[2] Të tre këta emra kanë të bëjnë me Revolucionin Francez. Termi sadizëm ndërlidhet me konceptin e de Sadiit se nuk mund të gjykohej krimi (qoftë edhe vrasja) që ndodhë gjatë dëshirës së dikujt për kënaqësi. [shën. i përkth]

[3] Ka të bëjë me një fjalë të Oruellit nga vepra 1984: Nëse dëshiron ta kesh një fotografi të së ardhmes, paramendoje çizmen që shkel mbi fytyrën e njeriut – përgjithmonë. [shën. i përkth]

[4] Magnetizmi i kafshëve, që ndryshe njihet si mesmerizmi, është teori e shpikur në shekullin XVIII nga Mesmeri – mjek gjerman. Teoria e tij parashtron ekzistencën e një force të padukshme natyrore (Lebensmagnetismus) që zotërohet nga të gjitha gjallesat, duke përfshirë njerëzit, kafshët dhe perimet. Sipas tij, kjo forcë që e fut njeriun në një gjendje të caktuar mendore, mund të ketë efekte fizike – përfshirë ato shëruese. Në vitin 1843, Brejdi – mjek skocez – e propozoi termin “hipnotizëm” si teknikë që rrjedh nga studimi i magnetizmit të kafshëve. Por, e hodhi poshtë idenë e Mesmerit se rrjedhja e lëngut magnetik shkakton fenomene hipnotike meqë, sipas tij, çdokush mund t’i shkaktojë ato “duke ndjekur rregullat e thjeshta”. Ai e refuzoi idenë që brejdizmi të jetë sinonim i “hipnotizmit”. Ezdeili – po ashtu mjek skocez i shekullit XIX – besonte se përmes mesmerizmit (që shpeshherë përdoret si sinonim i “hipnozës”) mund të zhduket dhimbja e pacientëve gjatë operacioneve. [shën. i përkth]

[5] Frojdi e ka përdorur hipnozën si mjet trajtimi dhe shërimi, por me zhvillimin e psikanalizës së tij e konsideroi si gjë të kotë. [shën. i përkth]

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Agon Xhaka pasi fiton çmimin 'Ylli i javës': Malisheva edhe në ndeshjet e tjera lufton për fitore



PRISHTINË, 4 DHJETOR - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 16 në Albi Mall Superligë i ka takuar futbollistit të FC Malisheva, Agon Xhaka. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga komisioni i veteranëve të futbollit në përbërje: Selatin Jerliu, Isuf Llumnica, Naim Kodraliu. Ky komision vlerësoi që Xhaka përveçse shënoi golin e fitores në

ndeshjen e rëndësishme dhe të vështirë me Llapin, pati paraqitje të mirë gjatë gjithë lojës. Pasi mori këtë çmim, Xhaka u shpreh i lumtur për fitoren dhe për vlerësimin si më i miri i xhiros. "Ndeshja ka qenë një sfidë e vështirë, pasi kishim përballë një kundërshtar të fortë. Por me punë, angazhim, disiplinë dhe me detyrat që na ka dhënë trajneri, arritëm të fitonim. Shpresoj që kjo fitore të jetë një hap shtesë, që edhe në ndeshjen e ardhshme t'i marrim

tri pikë. Është një ndjenjë e veçantë të jem i nderuar si ylli i javës si dhe një motiv shtesë për të punuar më shumë. Ky çmim shkoi si një falënderim për klubin e Malishevës dhe bashkëlojtarët që kanë kontribuar që unë sot të jem ylli i javës. Ne do të luftojmë edhe në ndeshjen e ardhshme në të njëjtën mënyrë, që t'i marrim tri pikë dhe të vazhdojmë drejt objektivave të klubit", ka thënë Xhaka për faqen zyrtare të FFK-së.

Ismajli: Shqipëria dhe Kroacia kalojnë grupin



ZAGREB, 4 DHJETOR - Ardian Ismajli ka dhënë një intervistë në mediet kroate, në të cilën ka folur për shortin e grupeve të Evropianit të Gjermanisë. Një periudhë të gjatë e kaloi te Hajduku në Kroaci dhe aktualisht është pjesë e Serisë A me Empolin. Për këtë arsye lojtari kuqezi është shprehur se dëshiron që Kroacia dhe Shqipëria të kalojnë

më tej. "Unë mendoj se ne do të marrim një rezultat të mirë në Evropian pavarësisht grupit sesa i fortë është. Nëse më pyesni mua, dua Kroacinë dhe Shqipërinë që të kalojnë më tej. Kroacia është e fortë, duke filluar që nga portieri, sulmues, veçanërisht mesfusha, Modriq, Kovaqiq, Brozoviq dhe Guardiol. I vetmi dyshim është se

në çfarë forme do të jetë Perisiqi", ka thënë Ismajli. "Ne? Nëse do të kemi Jasir Asanin në formën e tij më të mirë, do të jetë fantastike. Kemi një ekip shumë të organizuar, Berisha, Gjimshiti, Bajrami, Seferi, Ramadani, Muci, Asllani, Hysaj dhe Cikalleshi me Uzunin që kanë qenë këtu në Kroaci", ka deklaruar Ismajli.

SHKURT

KB Bashkimi ndan rrugët me trajnerin Kërveshi

Klubi i Basketbollit Bashkimi ka ndarë rrugët zyrtarisht me trajnerin Edin Kërveshi. Bashkimi dhe Kërveshi kanë ndërprerë kontratën me marrëveshje të dyanshme. Vendin e Kërveshit deri në emërimin e trajnerit të ri do ta zë ndihmëstrajneri Elbesar Gështhenja. "Faleminderit Edin Kërveshi! Klubi njofton se me marrëveshje të dyanshme është ndërprerë bashkëpunimi me trajnerin Edin Kërveshi. Trajnerin e falënderojmë për kontributin e dhënë deri më sot. Deri në një vendim të ardhshëm të klubit, skuadrën do ta drejtojë ndihmëstrajneri Elbesar Gështhenja", thuhet në njoftimin e klubit prizrenas.

FC Prishtina Futsal organizon turneun memorial 'Fadil Vokri'

FC Prishtina Futsal do ta organizojë turneun memorial kushtuar legjendës së futbollit Fadil Vokri. Klubi prishtinas përmes një njoftimi ka konfirmuar mbajtjen e këtij turneu që pritet të mbledhë ekipe të shumta të Kosovës. "Nga data 23 dhjetor FC Prishtina Futsal organizon turneun memorial "Fadil Vokri" i cili do të zhvillohet në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë. Edicioni i pestë është planifikuar që të ketë në program kategori të ndryshme, duke qenë gjithëpërfshirës për të gjitha grupmoshat", thuhet në njoftimin e FC Prishtina Futsal.

Në këtë turne, sipas këtij njoftimi, do të marrin pjesë: shkollat e futbollit të licencuara nga FFK, me kategoritë U13, U15 dhe U17. Gjithashtu këtë vit në formë gare do të jetë e pranishme Liga e Veteranëve e licencuar nga FFK, e në natën finale mediet e Kosovës dhe skuadrat me Syndrom Down. Ndeshjet do të drejtohen nga tre gjyqtarët e FFK-së që kanë stemën e FIFA-s.

KB Istogu largon tre lojtarë të huaj, transferon dy

Klubi i Basketbollit Istogu ka reaguar me ndryshime në skuadër pas rezultateve negative në elitën e basketbollit të Kosovës. Klubi i inkuadruar këtë sezon në Superligën e Kosovës ka larguar tre basketbollistë të huaj me marrëveshje të dyanshme për shkak të rezultateve jo të mira. Cooper, Whitley dhe Lang janë basketbollistët që janë larguar me marrëveshje të dyanshme me Istogun. Ndërkaq, klubi istogas nuk ka qëndruar duarkryq, por ka reaguar duke transferuar dy basketbollistë të huaj. Dooquan Brooks është zyrtarizuar si përforsim i ri i Istogut, me klubin që ka njoftuar pak më parë në faqen zyrtare. Emri i basketbollistit të ri të Istogut do të bëhet me dije së shpejti në faqen e klubit. Istogu pas 11 ndeshjeve në Superligë zë vendin e fundit me 12 pikë gjithsej.

Xhaka dhe Muslija, në formacionet e javës në Bundesligën 1 dhe 2

Futbollistët shqiptarë kanë vazhduar me paraqitje spektakolare në fundjavë në kampionatet më të forta evropiane. Në dy ligat më të forta në Gjermani, Bundesliga 1 dhe 2 ka vend për nga një futbollist nga Kosova në formacionin e javës. SofaScore ka publikuar formacionin e javës në Bundesliga 1, ku Granit Xhaka është pjesë e tij, pas një paraqitjeje të shkëlqyer ndaj Borussia Dortmundit. Përveç Xhakës, në formacionin e javës kanë zënë vend edhe yjet e tjerë si Florian Wirtz, Palacios, Klosterman ose Ryerson. Jo vetëm në Bundesligën 1, edhe në Bundesligën 2 ka pasur vend për një futbollist nga Kosova në formacionin e javës. Florent Muslija shënoi një gol të mrekullueshëm për Paderbornin në fitoren 1-0 ndaj Hannover 96 dhe zuri vend në formacionin e javës.

Todt për gjendjen e Schumacherit: Është pjesë e familjes sime, e takoj rregullisht

Pierrefort, 4 dhjetor - Po bëhen gati 10 vjet nga aksidenti me ski i Michael Schumacherit, 7 herë kampionit të botës në Formula 1 dhe në gjithnjë këto vite lajmet për gjendjen e tij janë të rralla. Një nga njerëzit më pranë pilotit gjerman është Jean Todt,

me të cilin Schumacheri shkroi historinë e këtij sporti kur ishin së bashku te Ferrari. Duke folur për "La Stampa", Todt ka deklaruar: "Në fillim marrëdhënia jonë ishte profesionale, por dalëngadalë kjo marrëdhënie u forcua

shumë derisa u bëmë miq të mirë. Michaelin e konsideroj një mik dhe është pjesë e familjes sime. Shkoj ta takoj rregullisht dhe në të shkuarën kemi parë mjaft gara së bashku. Gjendja e tij është private. E vetmja gjë që mund të them është se e

adhuroj Michaelin, e adhuroj familjen e tij dhe është e drejtë ta respektojmë privatësinë e tyre. Në marrëdhënien tonë kemi arritur shumë suksese dhe kjo na bën edhe më të pandarë", u shpreh Jean Todt, ish-drejtor sportiv i Ferrarit.



Ademi inkurajon zhvillimin e futbollit në takimin me Lidhjen Rajonale të Gjilanit

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, priti në takim përfaqësuesit e Lidhjes Rajonale të Gjilanit, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit dhe zhvillimit të futbollit në nivel rajonal. Në këtë takim, ku ishin të pranishëm edhe anëtarët e Komitetit Ekzekutiv, Naser Ajeti e Agim Nura, kryetari i FFK-së nënvizoi rëndësinë e Lidhjeve Rajonale për klubet, duke përmendur projektet dhe punimet infrastrukturore si një pjesë të rëndësishme të zhvillimit të futbollit. Ai theksoi rolin e bashkëpunimit ndërmjet FFK-së, komunave dhe klubeve, si dhe vuri në pah nevojën e bashkëpunimit dhe ndihmës reciproke në kuadër të masivizimit dhe zhvillimit të futbollit. I pari i FFK-së shprehu kënaqësinë që tash e dy vjet ua kanë hequr barrën klubeve për lëndimet e futbollistëve, falë



partneritetit të suksesshëm të FFK-së me Sigal Uniqa Group. Ai e vlerësoi sigurimin shëndetësor të futbollistëve si një arritje të rëndësishme për komunitetin e futbollit. Gjithashtu, kreu i FFK-së në këtë takim u përqendrua edhe në rëndësinë e identifikimit dhe promovimit të talenteve të reja,

duke theksuar se çdo talent duhet të ketë mundësi të hyjë në ekipet e përfaqësuesve të Lidhjeve Rajonale. Ky takim vjen pas konsolidimit dhe zgjedhjes së organeve të reja në rajonin e Gjilanit pak ditë më parë dhe nevojës për bashkërendim të prioriteteve.

Ramadani: Mund ta bëjmë mrekullinë në Gjermani

TIRANË, 4 DHJETOR - Shqipëria njohu kundërshtarët në finalen e Evropianit "Gjermani 2024", ku do të përballlet me Italinë, Kroacinë dhe Spanjën. Kundërshtarë të fortë në letër, duke pasur parasysh përvojën e këtyre skuadrave në arenën ndërkombëtare, por edhe trofetë e fituar. Në një prononcim për fshf.org, mesfushori i kombëtares, Ylber Ramadani, ka komentuar shortin e hedhur nga UEFA në Hamburg të Gjermanisë. Futbollisti, i cili aktivizohet me Leccen në Itali, theksoi se është një grup i vështirë. Megjithatë, sipas tij, asgjë nuk është e pamundur dhe Shqipëria do të shkojë në Gjermani për ta marrë maksimumin. Më tej, mesfushori kujezi shtoi se edhe në edicionin kualifikues Shqipëria u përball me kundërshtarë të fortë si Çekia dhe Polonia, por ia doli mbanë të bënte mirë. "Përhëndetje të



gjithëve! Siç e patë grupin tonë, një grup i vështirë me Spanjën, Kroacinë dhe Italinë, por ne do të shkojmë në Gjermani dhe do të tentojmë që ta bëjmë befasinë. Ne shkojmë atje që ta tregojmë nivelin e skuadrës sonë. Edhe në kualifikuese në Grupin E kemi pasur ekipe të vështira si Çekia dhe

Polonia. Ne do të shkojmë atje të luajmë, ta bëjmë maksimumin dhe të marrim rezultate pozitive. Nuk do të dorëzohemi lehtë. Një grup i vështirë, por ne mund të bëjmë mrekullinë në Gjermani. Ju përhëndes të gjithëve. Forca Shqipëri!", ka deklaruar Ramadani.

SHKURT

Gjasula: Fati i Serbisë që nuk ra në të njëjtin grup me Shqipërinë

Pas Etrit Berishës, Mirlind Dakut, është prononcuar edhe Klaus Gjasula në lidhje me shortin e "Euro 2024", i cili e ka përballur kombëtaren shqiptare me Spanjën, Kroacinë dhe Italinë. Emisioni "Koha shitesë" ka vazhduar me intervistat kushtuar kombëtares shqiptare. "Në këtë grup që kemi dhe me shortin që na ra, vetëm Brazili mungonte aty (qesh). Jo, mua më pëlqejnë shumë këto përballje. Do të kemi rivalë të fortë dhe me traditë. Mungesa e Serbisë në të njëjtin grup? Është fat i Serbisë që nuk është në grup me ne (qesh)", ka thënë Gjasula. "Por unë nuk e kisha mendjen se te cili grup u fut Serbia. Interes është vetëm te suksesi i Shqipërisë. Nëse do të na binte, gjithë vëmendjen do ta merrte vetëm ajo ndeshje. Ndoshta është më mirë kështu që të kemi vëmendjen vetëm te futbollit", ka shtuar Gjasula.

Torino interesohet për Brojën

Sulmuesi i Chelseat, Armando Broja, është synim i skuadrës së njohur italiane, Torino. "Tuttosport" raporton se Torino do të tentojë ta shesë Nemanja Radonjiq në merkaton e janarit, pasi ka pasur një përplasje me trajnerin. Ndërsa synim i klubit në fjalë është afrimi i Brojës. Sulmuesi shqiptar sapo është kthyer nga një lëndim që e mbajti gjatë jashtë fushave, por ka treguar se fiziku i tij është tepër i fortë edhe pas një ndalesë të gjatë, kështu që Torino do ta shqyrtojë mundësinë ta sjellë në Serinë A në janar.

Presidenti i Napolit: Humbëm për shkak të gjyqtarit

Napoli pësoi humbje 0-3 në derbin ndaj Interit. Presidenti i Napolit, Aurelio De Laurentiis, ka thënë se fajtor për këtë humbje është gjyqtari. "Ne nuk përfshihemi në teori konspirative. Ne humbëm për shkak të gjyqtarit. Na vjen keq për tifozët", ka thënë De Laurentiis. Pas kësaj humbje, Napoli renditet në vendin e pestë me 24 pikë, plot 11 pikë pas skuadrës së Interit që renditet në vendin e parë.

Barcelona mund ta lirojë Lewandowskin

Robert Lewandowski nuk po kalon në më të mirën e tij te Barcelona. Me tetë gola në 17 ndeshje, ai është shumë larg pritjeve. Kritikant për performancën e tij krahasuar me të ardhurat e tij vjetore prej rreth 26 milionë eurosh po bëhen gjithnjë e më të zhurmshme. Polaku është i lidhur me katalanasit deri në verën e vitit 2026. Megjithatë, në rrethana të caktuara, kontrata e tij mund të përfundojë para kohe. Sepse sipas gazetës spanjolle "Sport", një klauzolë në kontratë thotë: "Nëse Lewandowski nuk luan për të paktën 45 minuta në më shumë se 55 për qind të ndeshjeve këtë sezon, Barça do ta kishte opsionin për t'i dhënë fund kontratës në verën e vitit 2024". Por nuk duket kështu, së paku për momentin. Lewandowski është një lojtar i rregullt i padiskutueshëm.

Bellinghami fiton çmimin 'Golden Boy': Meritë e Ancelottit dhe fizioterapistit

Jude Bellingham është shpallur fituesi i padiskutueshëm i çmimit të përvitshëm "Golden Boy", që akordohet nga "Tuttosport", media torineze në Itali. Britaniku në një intervistë

ekskluzive për "Tuttosport" thekson se ndihet i nderuar për trofeun, aq më tepër kur shndërrohet në vetëm anglezin e tretë që e fiton këtë trofe pas Ronneyt dhe Sterling.

"Falënderoj të gjithë ata që më kanë votuar, i njoh mirë cilët janë fituesit e këtij trofeu prestigjioz që, ndër të tjera, ka lindur pikërisht në vitin 2003, atëherë kur kam lindur edhe unë. Jam

anglezi i tretë që e fitoj pas një prej idhujve të mi si Rooney dhe pas Sterling që e fitoi kur ishte pjesë e Liverpoolit në vitin 2014. 'Golden Boy' është një trofe shumë i bukur. Merita për këtë

trofe i shkon trajnerit Carlo Ancelotti, por edhe fizioterapistit. Ua dedikoj të gjithë shokëve dhe stafit të Real Madridit. Po ashtu edhe familjes sime", u shpreh Bellinghami.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me:
Priljeje: 04.12.2023

Njesia Jecnica: 01-462/01-66602

Numri: 01-462/01-66602

S tojca Dodatak



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

Në mbështetje të nenit 15 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/03 Prill 2019, neneve 14 dhe 20 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës e datës 10 gusht 2020, Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës Nr.15-462/01-53367, të datës 15.09.2023 dhe Vendimit për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës Nr.15-020/04-61653, të datës 30.10.2023, në ZK Konjuh, Komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit, shpallë:

**NJOFTIM PUBLIK
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME
TË KOMUNËS**

Komuna e Lipjanit në pajtim me Vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës Nr.15-462/01-53367 të datës 15.09.2023 dhe Vendimin për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës në ZK Konjuh, jep në shfrytëzim afatgjatë për 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite, pronat e paluajtshme me shënimet në tabelën si vijon:

Nr.	Pronar	Parcela Kadastrale	Zona Kadastrale	Sipërfaqe për shfrytëzim m ²
1	P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan	P-71409036-00164-15	Konjuh	13000 m ²
2	P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan	P-71409036-00164-51	Konjuh	8749 m ²
3	P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan	P-71409036-00164-18	Konjuh	15092 m ²
4	P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan	P-71409036-00164-26	Konjuh	2500 m ²
5	P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan	P-71409036-00164-27	Konjuh	2500 m ²
6	P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan	P-71409036-00164-21	Konjuh	10000 m ²

Page 1 of 4

V.P. Z.R. A.G. L.R. AD

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronave të cekura më lartë është krijimi i hapësirës për investitorët serioz për investim, sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore. Pronat komunale ofrohen në shfrytëzim për qëllimet e përcaktuara me Hartën Zonale të Komunës, përkatësisht për veprimtaritë si në vijim:

- Industri e lehtë prodhuese apo inovative;
- Shërbime biznesi;
- Administratë;
- Salla për ekspozime;
- Tregti;
- Hoteleri;
- Shërbime publike.

Bashkangjitur me këtë njoftim publik kemi edhe informata urbane lidhur me parcelat e publikuara, si mjedhojë përfituesit e pronave komunale para fillimit të realizimit të projektit duhet të plotësojnë të gjitha kërkesat për marrjen e kushteve ndërtimore dhe lejes ndërtimore sipas legjisllacionit në fuqi.

Aplikuesit, në momentin e konkurimit në pajtim me Rregulloren për Taksa Komunale duhet të paguajnë taksën në shumë prej 100 € (njëqind euro), për parcelën kadastrale të ofertuar, dhe jashtë kuvertës në njërin anë duhet të shënohet:

----- Zona Kadastrale, Konjuh -----

Njoftohen aplikuesit, se hapja publike e ofertave do të bëhet në ndërtesën e Komunës në Sallën e Kuvendit Komunal me datë: 20.12.2023 duke filluar nga ora 10:00 .

Kriteret për zgjedhjen e ofertave

Zgjedhja e ofertës më të favorshme për Komunën për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, bazohet në kriteret vijuese:

- 1 Vlera e investimit;
2. Numri i të punësuarve nga investimi;
3. Lloji i investimit që konsiderohet me interes dhe prioritet për Komunën;
4. Përfitimi financiar dhe ekonomik i komunës;
5. Të plotësoj kushtet dhe kriteret e përcaktuara mjedisore;
6. Si dhe të jetë në harmoni me hartën zonale të Komunës së Lipjanit.

Page 2 of 4

V.P. Z.R. A.G. L.R. AD.

Pjesëmarrësve në konkurim u garantohet e drejta që të:

- Informohen lidhur me procedurat e njoftimit publik;
- Të shohin pronën që do të jetë objekt i dhënies në shfrytëzim;
- Të kenë qasje në dokumentacionin e pronës;
- Të tërhiqen nga konkursi jo më vonë se tre (3) ditë para hapjes së ofertave

Ofertuesit kanë të drejtë aplikimi për marrje në shfrytëzim vetëm për një parcelë, në të kundërtën aplikimi i tyre nuk do të shqyrtohet.

Oferta duhet të përmbajë: shënimet e ofertuesit, numrin e këtij Njoftimi publik, datën e përpilimit të ofertës, titullin OFERTË, shënimin mbi pronën për të cilën ofertohet, emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e ofertuesit për personin fizik, ndërsa për personin juridik edhe funksionin e personit përgjegjës.

Oferta e personit fizik duhet të nënshkruhet nga personi fizik, ndërsa oferta e personit juridik nënshkruhet dhe vuloset nga personi përgjegjës i personit juridik.

Oferta për pronën e caktuar duhet të vendoset në kuvertë të mbyllur për parcelën kadastrale të ofertuar.

Koverta në faqen e parë duhet të përmbajë shënimin:

**Komisionit vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme
të Komunës së Lipjanit për Njoftimin publik**

Tërheqja e aplikacioneve mund të bëhet në ndërtesën e Komunës kati I-rë në Qendrën për Shërbime për Qytetarë sporteli Nr.1 dhe 2 në formën fizike dhe në formë elektronike nga Uebfaqja e Komunës.

Aplikacioni bashkë me ofertën në kuvertë të mbyllur për parcelën kadastrale dorëzohet në ndërtesën e Komunës kati I-rë në Qendrën për Shërbime për Qytetarë sporteli nr. 1 dhe 2 në afat prej 15 ditësh kalendarike pas ditës së publikimit të këtij Njoftimi, konkretisht njoftimi është i hapur deri më datën 19.12.2023 në ora 16:00.

Ofertat e pakompletuara, të paprecizuara, të panënshkruara, sipas aplikacionit, nuk do të shqyrtohen.

Gjatë hapjes së ofertave marrin pjesë nënshkruesit e ofertave apo të autorizuarit e tyre me autorizim noterial.

V.P. Z.R. A.G. L.R. AD.

Page 3 of 4

Njoftimi për ofertën e përzgjedhur do t'i dërgohet fituesit pas aprovimit nga Kuvendi i Komunës dhe do të publikohet në Uebfaqen e Komunës dhe në tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës.

Vëmendje: Oferta (Investitorët) përfitues të përzgjedhur për shfrytëzim në parcelat e lartëcekura obligohen që të dorëzojnë garancionin bankar nga banka në vlerë prej 3% të shumës së paraqitur si vlerë investive, si parakusht kontraktual me komunën për marrjen në shfrytëzim të këtyre parcelave, garancioni do shërbejë si peng deri në finalizimin e projektit të tyre sipas planeve të paraqitura biznesore dhe marrëveshjes kontraktuale.

Informatat shtesë mund të merren në Ndërtesën e Komunës, kati i tretë - Sektori pronësor-juridik ose në tel 038-200-41-507.

1.Valon Pacolli

2. Latif Ramadani

3. Armend Grajqevci

4.Lulzim Rrustemi

5.Arbnora Dedushi

Me datë: 04.12.2023



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KUVENDI I KOMUNËS

-Komisioni vlerësues për dhënicë në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit-

APLIKACION
PËR KONKURS PUBLIK

Në bazë të Konkursit publik për dhënicë në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Nr. _____ të datës _____ aplikoj për marrjen në shfrytëzim afatgjatë të pronës me këto shënime:

Zona kadastrale	
Vendi	
Ngastra kadastrale	
Sipërfaqja	
Aplikoj për pronën me numër rendor	(shëno numrin)

APLIKUESI – PERSON FIZIK

Emri, Mbiemri dhe numri i telefonit	
Vendbanimi	
Adresa	
Emri dhe mbiemri të autorizuarit	
Numri dhe data e autorizimit	

APLIKUESI – PERSON JURIDIK

Emërtimi i biznesit dhe numri kontaktues	
Selia	
Adresa	
Numri i biznesit	
Përfaqësuesi	
I autorizuarit	
Numri dhe data e autorizimit	

Aplikacionit i bashkëngjeshë kovertën e mbyllur me dokumentet si në vijim:

- Ofertën;
- Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të subjektit aplikues;
- Vërtetimi nga Gjykata që dëshmon që pronari dhe biznesi nuk është nën hetime (kërkohe origjinali, jo më i vjetër se 30 ditë)
- Vërtetimin e qarkullimit vjetor të subjektit aplikues minimalisht për vitin fiskal 2021 nga Administrata Tatimore e Kosovës;

V.P. L.R. A.G. L.B. AD.

1

5. Vërtetimin tatimor të subjektit aplikues për obligimet e kryera ndaj Administratës Tatimore të Kosovës, jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj;

6. Projekti tekniko-investiv, në kuadër të këtij plani duhet të përfshihet pjesa tekstuale dhe grafike e projektit ku përfshihen:

1. Veprimtaria e planifikuar
2. Sipërfaqja ndërtimore e projektit;
3. Vlera dhe paramasa investive (nëse vlera investive ndahet në faza, atëherë të prezantohet sipas fazave zhvillimore);
4. Periudha e realizimit të projektit;
5. Numri i punonjësve të angazhuar;
6. Aplikimi i standardeve mjedisore, përkatësisht ndikimi i veprimtarisë së planifikuar në mjedis;
7. Pjesa grafike e projektit;

7. Fotokopjen e certifikatës mbi regjistrimin e biznesit;

8. Dëshmi e xhirologarisë aktive dhe qarkullimin bankar për vitet: 2021, 2022, 2023.

9. Pagcsën e taksës për aplikim.

Lipjan, më datë _____ 2023

APLIKUESI

Emri dhe Mbiemri

Nënshkrimi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN
SKUPŠTINA LIPLJAN

Data: 22.11.2023

Numri i vrojtimt: 8-462/01-64740

Në bazë të Vendimit për Miratimin e Hartës Zonale për Komunën e Lipjanit me Vendimin e Kuvendit Komunal 15Nr.30033 dt.03.06.2021 K.K.Lipjan dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 05/1.-031 si dhe aplikacionit dhe dokumenteve të prezentuara, Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit lëshon këtë:

INFORMACION URBAN

Ky Informacion i lëshohet:

Emri dhe mbiemri	Valon Pacolli –Drejtor për Ekonomi dhe Zhvillim		
Adresa	Rr.Shqipëria -Lipjan		
Për Lokacionin në vijim;			
Adresa:	Zona Komerciale Konjuh		
Zona kadastrale:	Konjuh	Parcela kadastrale:	P-71409036-00164-15 P-71409036-00164-51 P-71409036-00164-18 P-71409036-00164-26 P-71409036-00164-27 P-71409036-00164-21

Përshkrim:

Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke shqyrtuar kërkesën 8-350/01-64740 dt.20.11.2023, lidhur mbi gjendjen e planifikuar në zonën në të cilën janë të koncentruara parcelat kadastrale P-71409036-00164-15, P-71409036-00164-51, P-71409036-00164-18, P-71409036-00164-26, P-71409036-00164-27 dhe P-71409036-00164-21, bazuar në të dhënat nga Harta Zonale e Komunës së Lipjanit të miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal 15Nr.30033 dt.03.06.2021 ju njoftojmë si vijon:

Ky Informacion lëshohet për parcelat P-71409036-00164-15, P-71409036-00164-51, P-71409036-00164-18, P-71409036-00164-26, P-71409036-00164-27 dhe P-71409036-00164-21 e cila gjenden brenda kufinjve të zonës Komerciale . Ku sipas HZK shfrytëzimet e lejuara për zonën në fjalë i gjeni të bashkangjitura në shtojcën në vijim pjesë e HZK-së.

Shtojcë :

Skicat grafike – pjesë nga HZK.
ZK [Zona Komerciale]

Ky Informacion i dorëzohet :

- Parashtruesit të kërkesës
- Në shkresat e lëndës
- a/a

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT
8Nr.462/01-64740 dt. 22.11.2023

Përpunoi:

Abetare Rexhepi
Zyrtare për Letë Ndërtimore

Kontrolloi:

Hasim Vishesella
Shef DPUMM

Imri Semetishiti
Drejtor i DPUMM-së

Pranuar: _____

Data: _____

5.3 [ZK] ZONË KOMERCIALE

Kjo zonë është e planifikuar për shfrytëzim komercial. Zona komerciale ka sipërfaqe totale prej 769 ha, nga e cila 138.8 ha (18%) shtrihet në zonë urbane, ndërsa 630.2 ha apo (82%) jashtë zonës urbane. Zona ofron hapësirë për zhvillim të tregtisë dhe industrisë së lehtë. Në të njejtën kohë zona do të akomodojë shfrytëzime tjera të cilat janë në shërbim të zonës. Zona komerciale planifikohet të zhvillohet në dy lokacione, një sipërfaqe brenda zonës urbane në qytet, dhe sipërfaqja tjetër jashtë zonës urbane.

5.3.1 SHFRYTËZIMI I TOKËS

Shfrytëzimet e lejuara

- Shërbim tregtar: hapësira për shitje me shumicë të mallrave shtëpiake, tekstile, ushqim, dhe pije; shërbim i akomodimit të ushqimit (restorant/bare); automekanik; dhe autolarje.
- Industri e lëndës së parë: prodhim i produkteve të tekstilit, drurit, letrës, kimike dhe firave, metaleve, minerale, të gomës dhe plastikës.
- Industri e prodhimeve të lehta: prodhim i pijeve dhe produkteve të duhanit, rrobave dhe lëkurës, botim dhe shtyp, dhe pajisje elektrike dhe optike.
- Shërbim profesional financiar dhe i informacionit: shërbime bankare.

Shfrytëzimet dytësore

Shfrytëzime dytësore konsiderohen si të tilla të gjitha ato shfrytëzime që shërbejnë si plotësim për shfrytëzimin primar të tokës. Shfrytëzime dytësore janë të gjitha shfrytëzimet (ndërtesat apo strukturat teknike) që shërbejnë si funksion mbështetës për shfrytëzimin primar të tokës. Në vijim janë paraqitë shfrytëzimet dytësore në funksion të parcelave me shfrytëzim primar:

- Shfrytëzim primar: industri; shfrytëzim dytësor: kaldaja, depo, dhe trafo të rrymës.


Shfrytëzimet e veçanta

- Industri e prodhimeve të lëndës së parë (Shiko kaptinën 6 për kushte zhvillimore për shfrytëzime të veçanta).


Shfrytëzime e ndaluara

Ndalohen të gjitha shfrytëzimet të cilat nuk janë të renditura në listën e shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, dhe të veçanta.

HARTA 7: HARTA E ZONËS KOMERCIALE DHE INDUSTRIALE



HARTA 8: HARTA E ZONËS EKONOMIKE



Harta Zonale e Komunës, Lipjan [final Qershor 2021]

5.3.2 KUSHTET ZHVILLIMORE

Treguesit bazë	Qytet		Pjesë tjera		
	Shërbim tregtar	Industri e lëndës së parë dhe prodhimeve të lehta	Shërbim tregtar	Shërbim profesional	Industri e lëndës së parë dhe prodhimeve të lehta
Madhësia e parcelës	Min 1000m ²	Min 500m ²	Min 500m ²	Min 500m ²	Min 1,000m ² Max 1,500 m ²
Dall i parcelës	Min 20m'	Min 20m'	Min 15m'	Min 15m'	Min 30m'
Indeksi i Sipërfaqes së Ndërtuar (ISN)	Vlera bazë 0.5 Max 1.5	Vlera bazë 0.50 Max 1	Vlera bazë 0.50 Max 1	Vlerë bazë 0.50 Max 1	Vlera bazë 0.50 Max 1
Etazhiteti	R+P+2 Max 12m'	P + 0 (7.0 m') P + 1 (12 m')	R+P+1 Max 9 m'	R+P+1 Max 9 m'	P + 0 (7.0 m') P + 1 (12 m')
Indeksi i Shfrytëzimit të Parcelës Kadastrale për Zhvillim (ISHPKZh)	Max 50%	Max 50%	Max 50%	Max 50%	Max 50%
Sipërfaqja gjelbëruese e parcelës (SGJP)	20%	20%	20%	20%	20%
Sipërfaqja nëntokësore e parcelës (SNP)	50%	0%	50%	50%	0%
Rrjetet e vijave					
Vija Ndërtimore (VN)	Min 6m Përveq kur përcaktohet nga ligji për rrugët	Min 6m Përveq kur përcaktohet nga ligji për rrugët	Min 8m Përveq kur përcaktohet nga ligji për rrugët	Min 8m Përveq kur përcaktohet nga ligji për rrugët	Min 8m Përveq kur përcaktohet nga ligji për rrugët
Vija Ndërtimore Nëntokësore (VNNI)	Min 6m	Min 6m	Min 8m	Min 8m	Min 8m
Distanca anësore nga parcela – me hapje primare	Min 0.25H e ndërtesës	Min 0.25H e ndërtesës	Min 0.25H e ndërtesës	Min 0.25H e ndërtesës	Min 0.25H e ndërtesës
Distanca anësore nga parcela – me hapje sekondare	Min 0.10H e ndërtesës	Min 0.10H e ndërtesës	Min 0.10H e ndërtesës	Min 0.10H e ndërtesës	Min 0.10H e ndërtesës
Distanca anësore nga parcela – pa asnjë lloj hapje	Ndërtesa mund të ndërtohet deri në kufi të parcelës me kusht që pronarët e parcelave fqinje arrijnë marrëveshje të ndërsjellë të vërtetuar nga Noteri.				

1: Gjerësia minimale e ballit të parcelës varet nga madhësia e parcelës. Gjerësia minimale e ballit të parcelës rritet proporcionalisht me rritjen e madhësisë së parcelës. Rritja e gjerësisë fillon nga vlera bazë e ballit të parcelës të paraqitur në shtyllën përkatëse për çdo shfrytëzim të lejuar. Për çdo rritje të madhësisë së parcelës nga 0 - 100m², gjerësia minimale e ballit të parcelës duhet të rritet për 2.0m', p.sh:


- Industri e lëndës së parë: madhësia e parcelës 500m² – 600m² = 20.0m' (gjerësia minimale e ballit të parcelës – vlera bazë);
- Industri e lëndës së parë: madhësia e parcelës 601m² – 700m² = 22.0m' (gjerësia minimale e ballit të parcelës).

Kjo rregull vlenë për të gjitha llojet e shfrytëzimeve të lejuara në këtë zonë.

5.4 [ZBJ] ZONË BUJQËSORE

Sipas Ligjit Nr.02/L-26 për tokën bujqësore: "Toka bujqësore është toka e shfrytëzuar për kultivimin e kulturave bujqësore si arë, fidanishite, pemishte, vreshta, livadhe, kullota, hurdhja peshku dhe moçale,

Harta Zonale e Komunës, Lipjan [final Qershor 2021]



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "G3 Oil" Sh.p.k, Mitrovicë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Statcionin e Karburateve në Z.K. Shupkovc, Komuna Mitrovicë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 25.01.2024 në ora 11:00 në hapësirat e SHFMU "Shemsi Ahmeti" në Shupkovc, do të organizohet debat publik nga Kompania "G3 Oil" Sh.p.k, Mitrovicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM.

<https://us04web.zoom.us/j/7491688086?pwd=U05XRGMzcHpHRjl1OHhxdmNpUWJJCUT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "G3 Oil" Sh.p.k, Mitrovicë, për Statcionin e Karburateve në Z.K. Shupkovc, Komuna Mitrovicë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnk.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "OnPoint Studio" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811307968 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "OnPoint Studio" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811307968 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "OnPoint Studio" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811307968 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë





www.facebook.com/gjeipuneshpejte

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- M.T.P. "M-R Coom" shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330038564.

- Rajmonda Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hjadar Dushi" Gjakovë.

- Arlind Koci nga Gjakova shpall të pavlefshme shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. të shkollës së mesme Teknikë "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Fakt Xharra nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hjadar Dushi" Gjakovë.

- Arsim Bektashi shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme "Arkitekt Sinani".

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



Bazuar në nenin 38, paragrafi 3 dhe paragrafi 4, të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 05/L-150 (këtu e tutje: Ligji për BQK-në), Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) shpall:

KONKURS
për
Zëvendësguvernator/e
për Mbikëqyrje Financiare

Zëvendësguvernatori/ja për Mbikëqyrje Financiare është pozitë e lartë ekzekutive (mbi nivelin e drejtorëve të departamenteve). Zëvendësguvernatori/ja për Mbikëqyrje Financiare shërben si anëtar/e i/e Bordit Ekzekutiv dhe e ndihmon Guvernatorin në realizimin e operacioneve të BQK-së. Është i/e ngarkuar me funksionet e BQK-së për licencim dhe mbikëqyrje të bankave, kompanive të sigurimit, fondeve pensionale dhe institucioneve të tjera financiare. Po ashtu mund të ngarkohet me detyra dhe përgjegjësi shtesë ose portofol tjetër sipas strukturës organizative.

Profili i kërkuar i kandidatit:

- Të jetë shtetas/e i/e Kosovës;
- Të jetë me integritet;
- Të ketë diplomë universitare (studimet themelore);
- Të ketë minimum dhjetë (10) vite përvojë profesionale ose akademike në fushat e ekonomisë, financave, bankave, kontabilitetit apo çështjeve juridike;
- Të ketë njohuri në zhvillimin dhe implementimin e politikave të rëndësishme të lidhura me objektivat dhe detyrat e BQK-së;
- Të përmbushë kërkesat nga neni 40 i Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës;
- Diplomati universitare mbi nivelin e studimeve themelore paraqesin përparësi;
- Përvoja dhe aftësia menaxheriale relevante paraqet përparësi;
- Përvoja profesionale dhe menaxheriale në mbikëqyrje të institucioneve financiare paraqet përparësi;
- Njohja e gjuhës angleze dhe gjuhëve tjera paraqet përparësi.

Dokumentet e kërkuara për pozitën në fjalë:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim (mund ta shkarkoni në www.bqk-kos.org);
- Curriculum Vitae (CV);
- Letër motivuese (të elaborohet ndërlidhje me përvojës dhe/ose kualifikimit me pozitën e synuar);
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit;
- Kopjet e noterizuara të diplomave, ndërsa për diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës kopjet e nostrifikimeve të noterizuara të në Republikën e Kosovës të tyre (E detyrueshme: diploma e studimeve themelore);
- Dëshmi mbi përvojën e punës (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale). Raporti nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusi) për periudhën përkatëse, i preferueshem si dokument shtesë;
- Certifikatën nga Gjykata kompetente, e cila dëshmon se kandidati/ja nuk ka qenë asnjëherë subjekt i ndonjë veprë penale (certifikatë kjo jo më e vjetër se 3 muaj); dhe
- Vërtetimin nga Policia që dëshmon se kandidati/ja nuk është nën hetime (vërtetim ky jo më i vjetër se 3 muaj).
- Certifikatat profesionale, rekomandimet dhe referencat relevante (opsionale).

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të lartcekur në e-mail adresën elektronike paneli@bqk-kos.org, duke e vendosur si titull (subjekt): Aplikimi për Z.G. për Mbikëqyrje Financiare

Afati i fundit për aplikim është 18 dhjetor 2023 (ora 23:59)

Vetëm kandidatët e përzgjedhur që plotësojnë kushtet formale dhe kërkesat e konkursit me dokumente të kompletuara, do të ftohen për intervistë nga Paneli.



Na osnovu člana 38. stav 3. i stava 4. Zakona br. 03/L-209 o Centralnoj banci Republike Kosovo, izmenjen i dopunjen Zakonom br. 05/L-150 (u daljem tekstu: Zakon o CBK), Centralna banka Republike Kosovo (CBK) raspisuje:

KONKURS
za
zamenika guvernera
za finansijski nadzor

Zamenik guvernera za finansijski nadzor je visoka izvršna pozicija (iznad nivoa direktora odjeljenja). Zamenik guvernera za finansijski nadzor služi kao član Izvršnog odbora i pomaže guverneru u obavljanju operacija CBK. Zadužen je za funkcije CBK-a za licenciranje i nadzor banaka, osiguravajućih društava, penzionih fondova i drugih finansijskih institucija. Takođe se može zadužiti dodatnim dužnostima i odgovornostima ili drugim portfolijom prema organizacionoj strukturi.

Traženi profil kandidata:

- Da je državljanin Kosova;
- Da ima integritet;
- Da ima fakultetsku diplomu (osnovne studije);
- Da ima najmanje deset (10) godina profesionalnog ili akademskog iskustva u oblasti ekonomije, finansija, bankarstva, računovodstva ili pravnih pitanja;
- Da ima znanje u razvoju i sprovođenju važnih politika u vezi sa ciljevima i zadacima CBK-a;
- Da ispunjava uslove iz člana 40. Zakona br. 03/L-209 o Centralnoj banci Republike Kosovo;
- Univerzitetske diplome iznad osnovnih studija predstavljaju prednost;
- Relevantno menadžersko iskustvo i sposobnost predstavljaju prednost;
- Profesionalno i menadžersko iskustvo u nadzoru finansijskih institucija predstavlja prednost;
- Poznavanje engleskog i drugih jezika predstavlja prednost.

Potrebna dokumenta za navedenu poziciju:

- Službeni obrazac CBK-a za prijavu (možete preuzeti na www.bqk-kos.org);
- Biografija (CV);
- Motivaciono pismo (elaborirati povezanost između iskustva i/ili kvalifikacije sa ciljnom pozicijom);
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte;
- Overene kopije diploma, dok za diplome stečene van Republike Kosovo, kopije nostrifikacija overenih u Republici Kosovo (obavezno: diploma osnovnih studija);
- Dokaz o radnom iskustvu (kopije ugovora ili potvrde poslodavca ili drugi relevantni dokumenti koji služe za dokazivanje pozicije i radnog iskustva, bez kršenja relevantnih akata za zaštitu ličnih podataka). Izveštaj iz Fonda penzione štednje Kosova (Trust) za relevantni period, poželjno kao dodatni dokument;
- Uverenje nadležnog suda kojim se dokazuje da kandidat nikada nije počinio krivično delo (uverenje ne starije od 3 meseca); i
- Uverenje policije kojim se dokazuje da kandidat nije pod istragom (uverenje ne starije od 3 meseca).
- Profesionalni sertifikati, preporuke i relevantne reference (opciono).

Zainteresovani kandidati moraju dostaviti gore navedenu kompletnu dokumentaciju na elektronsku e-mail adresu paneli@bqk-kos.org, stavljajući kao naslov (subjekat): *Prijava za Z.G. za finansijski nadzor*

Zadnji rok za podnošenje prijava je 18. decembar 2023. godine (23:59 časova)

Na razgovor od strane Komisije biće pozvani samo izabrani kandidati koji ispunjavaju formalne uslove i uslove konkursa sa kompletnom dokumentacijom.

